

Poeti dhe studiuesi Sadik Bejko, në një intervistë ekskluzive për "Exlibris", flet për herë të parë për krijimtarinë e vet, duke u ndalur në përbledhjen poetike "Këngë të Solomonit" dhe në librin tjetër monografik "Disidentët e rremë". Po ashtu ai analizon letërsinë shqipe nën diktaturë dhe në ditët e sotme, për majat e saj që na përfaqësojnë në metropolet europiane e botërore, për debatin e munguar kulturor dhe për etapat më të ndritshme të krijimit shqip. Gjithashtu studiuesi Bejko apelon për mbështetje më të madhe shtetërore ndaj gjuhës shqipe, një nga më të vjetra të Europës, që ka tërhequr vëmendjen e linguistëve më të shquar të rajonit e më gjerë. Bejko ndalet edhe në krijimtarinë e Kadaresë, duke e konsideruar atë si pjesë të krijimit botëror.

SADIK BEJKO:

Letërsia shqipe në gjysmën e dytë të shek. XX doli nga provincializmi

Intervistoi: Çerçiz Loloçi




Dy shkrimtarë, dy botë asimetrike:

P. Marko dhe E.

Hemingway

nga Virion Graçi



SIMFONIA E SHENJTË

(Kushtuar piktorit Zef Kolombi)

nga Hyjni Ceka

REPORTAZH



KALABRIA KY
"KOPËSHT
EKZOTIK"!

nga Alba Kepi

Inagurohet Biblioteka "Zoja e Shkodrës"

Fjalori i
Kostandin Kristoforidhit
dhe diplomacia greke

Hasan BELLO



BLLOKU I
SHËNIMEVE

JOAN
DIDION

NJË SHTËPI
E QETË

Marie Luise
Kaschnitz

BIBLIOTEKË

Nerinda Hysa

TRUPA NË
RANIE



Poeti dhe studiuesi Sadik Bejko, në një intervistë ekskluzive për "Exlibris", flet për herë të parë për krijimtarinë e vet, duke u ndalur në përblehjen poetike "Këngë të Solomonit" dhe në librin tjetër monografik "Disidentët e rremë". Po ashtu ai analizon letërsinë shqipe nën diktaturë dhe në ditët e sotme, për majat e saj që na përfaqësojnë në metropolet europiane e botërore, për debatin e munguar kulturor dhe për etapat më të ndritshme të krijimit shqip. Gjithashtu studiuesi Bejko apelon për mbështetje më të madhe shtetërore ndaj gjuhës shqipe, një nga më të vjetra të Europës, që ka tërhequr vëmendjen e linguistëve më të shquar të rajonit e më gjerë. Bejko ndalet edhe në krijimtarinë e Kadaresë, duke e konsideruar atë si pjesë të krijimit botëror.

Sadik Bejko:

Letërsia shqipe në gjysmën e dytë të shek. XX doli nga provincializmi

Intervistoi: Çerçiz Loloçi

Për një poet dhe studiues ka gjithmonë profile dhe këndvështrime të ndryshme, megjithatë merr rëndësi se si e shikon ai vetveten?

Nuk është keq kur në një moshë të caktuar e ke arritur statusin që njerëzit të të njohin si poet, si studiues. Më shpesh, nga që kam qenë mësimdhënës për mbi tri dekada, më thërrasin dhe "profesor". Nuk e kam titullin e profesorit, por mbase se për një poet a studiues në moshë duhet të gjesh një mënyrë distancimi se si t'u drejtohesh.

Për hir të profesionit si ligjërues në universitet kam bërë artikuj shkencorë, libra universitarë, monografi mes të cilave edhe për letërsinë arbëreshe, kam mbrojtur gradën shkencore të doktorit në letërsi. Megjithatë për veten mendoj se, nuk jam studiuesi tipik i letërsisë, më tepër një eseist do ta quaja veten.

Sa për poetin...në rini e kam qenë i dëshiruar të jem poet. Ishte mosha dhe koha kur shkruhej shumë poezi. Më pas, kam dashur ta lë për fare. Por më mbeti në shpinë dhe e shtyva deri më sot. Kur ta bëjnë të vështirë, apo kur e pësokë prej një pune të tillë, në vend që të ikësh prej saj, kthehesh e i rikthehesh më ngulmueshëm.

Vëllimi juaj i fundit 'Këngë të Solomonit' pati një pritje të mire nga lexuesit, madje disa krijime të kësaj përmbledhje u publikuan edhe në anglisht dhe italisht; mendimi juaj?


Libri "Këngë të Solomonit" përmbledh poezi të 10 vjetëshit të fundit. Një moshë thonë kur poezinë e braktisin. Një moshë kur shkruhen kujtime, ese, prozë meditative. Duke qenë se po e botoja në të 75-at e mia e quajta "Këngë të Solomonit". Nga tradita e poezisë shqipe poetët tanë, me përjashtim të Fatos Arapit, nuk kanë shkruar poezi të reja rreth kësaj moshe.

E quajta këngë se në traditën botërore, që nga 'Kënga e këngëve', të shkruash poezi, do të thotë të

këndosh. Komedia Hyjnore e Dantes përbëhet nga 100 canto (këngë), Il Canzoniere e kanë quajtur përmbledhjen me sonete të Petrarkës. De Rada ka shkruar "Këngët e Milosaos", një poet modern Ezra Pound – Cantot e Pizës.

Libri u prit mirë nga lexuesi i poezisë, nga kritika profesioniste po ashtu. Për librin shkruan Prof. Josif Papagjoni, Prof. Ali Aliu, por edhe disa poetë e publicistë. Në Panairin e Librit në Fier libri mori çmimin si libri poetik më i mirë i vitit.

Sigurisht unë kam dhe një lexues më intim, miq e shokë të vjetër, poetë, mësues, pedagogë që në biseda a postë elektronike më përcjellin mendimet e tyre. Në disa rrethana si tek ne, ku mungon kritika, ose, kur për arsye jashtëletrare, mund të kesh mbetur jashtë vëmendjes, një lexues i tillë 'intim', nuk të lë kurrë në baltë. Nga ballafaqimi me të verifikon veten, punën tënde.



Disa dashamirës të mi muajt e fundit kanë përkthyer cikle poezish në anglisht, greqisht, italisht dhe i kanë hedhur në internet.

Solomoni antik ka qenë mbret dhe simbol i urtësisë, pra, këngët e mia të "urtësisë", gjetën një lexues (atë lexues që ka poezia) që i mirëpriti.

Ju keni qenë i ndaluar të botonit në diktaturë, por ndërkaq jeni përballur me vështirësi të tjera, së paku për të botuar; janë disa libra tuaja që presin një botues?

Kam qenë dy vjet ushtar në brigadë pune, gjashtë vjet punëtor nëntoke në minierën e qymyrgurit Memaliaj. Dhjetë vjet nuk kam pasur të drejtë botimi. Por kësaj historie me kohë i kam vënë pikë. Fat i keq për mua. Kaq.

Në diktaturë të gjithë poetët, artistët, shkrimtarët, kush më shumë e kush më pak, e kanë marrë nga një dajak pas koke. Disa e kanë paguar me kokë, me burg a me punë të rëndë që të mbaheshin nën fre të tjerët. Këtë e them se duhet të kishte marrë fund ajo kënga e stërgjatë me fjalët "unë kam vuajtur nga sistemi, ti i ke shërbyer sistemit". Ky avaz nuk i shërbeu askujt, as atyre që viktimizonin veten, për të goditur të tjerët. Për të goditur më të mirët, se me të tjerët nuk merret njeri. Edhe dosjet nuk u hapën, po u përdorën për t'i bërë pis të gjitha palët. Këto e prishën, e vranë edhe atë pak klimë krijuese që i duhet letërsisë së një kohe për të shkruar përpara.

Të flasim për 'ndalimet' në të sotmen.


Një që shkruan poezi duhet të mësohet të jetojë me faktin e trishtuar se të jesh poet, do të thotë të jesh disi i ndaluar. Do të thotë: si poet lexohesh pak, ose dhe aspak. Librat do t'i botosh me paratë e tua. Nobelisti Tomas Eliot në Angli qe punonjës banke. Ngrihej në orën pesë të mëngjezit, punonte mbi poezitë dy-tre orë, pastaj...në bankë. Wollas Stivens në Amerikë gjithë jetën punoi në një agjenci sigurimesh. Poezitë i botoi me paratë e veta. Nuk jetonte në shoqëri poetësh. Sot mbahet poeti më i madh amerikan. Nobelisti grek Odisea Elitis, po ashtu i botonte vetë poezitë e tij dhe me një tirazh që nuk i kalonte 50 kopjet.

Më të shumtët e librave me poezi i kam botuar me paratë e mia. Më mirë që i botova, sesa t'i mbaja në sirtar. Mësova kompjuterin që t'i radhis vetë të gjithë librat e mi.

Çfarë kam në sirtar? Kam ese mbi libra dhe shkrimtarë, ese me trajtime më tej letërsisë, publicistikë që mund t'i përmbledhja në një-dy libra. Mund të bëja dhe një përzgjedhje të poezive... por edhe po nuk i bëra këto libra, shkrimet tani janë on line, ose janë në gazeta e revista.

Ashtu si mbarë krijimi botëror, edhe krijimtari shqipe ka periudhat e saj të ndritshme dhe ato me më pak shkëlqim; si do t'i përcaktonit ju këto periudha për letërsinë shqiptare?

Letërsia shqipe mori krahë në periudhën e Rilindjes kombëtare. Periudha pasuese, ajo e Pavarësisë, siç quhet, për mua ka qenë e jashtëzakonshme. Shpërthimi i energjive të fjetura u dha në të gjitha fushat e krijimit, në teatër, në novelistikë, në roman, në poezi, në fushën e ideve, në folkloristikë (Visaret e Kombit, Kanuni i Lekë Dukagjinit) dhe në publicistikë. Në këtë periudhë dhanë frytet e tyre të fundme krijuese, apo arritën pjekurinë disa figura që vinin nga Rilindja, si: Çajupi, Mjeda dhe Asdreni. Këta e pasuruan krijimtarinë, prekën deri nervin e modernitetit. Fishta përfundoi Lahutën e Malcisë, lëvroi me shumë sukses satirën, dramën,



poezinë mistike. Midhat Frashëri shënon fillimet e prozës së shkurtër (1914). Kjo prozë arriti kulmin me mjeshtra të pasqor si Koliqi dhe Mitrush Kuteli. Fan Noli, lëvruer i poezisë, i prozës poetike dhe historike është një nga kapacitetet e paarritshme edhe sot në fushën e përkthimeve. Faik Konica vazhdoi me esetë dhe publicistikën. Lasgush Poradeci i dha poezisë, fjalës shqipe një luks vështirë të kapërcyeshëm. Lasgushi krijoi frymë (finesë aristokratike, ngrohtësi, ëmbëlsi) të panjohura këto ndonjëherë për ashpësinë e shpirtit të lashtë shqiptar. Migjeni me verbin e vrazhdë të së përditshmes e zbriti nga malet shqiptarin dhe shqiptaren drejt e në llumin e mjerimit më tragjik. Haxhiademi krijoi një korpus tragjedish të stilit neoklasicist. Brezi i më të rinjve erdhi me prirjen majtiste në letërsi. Spasse do të shkruante romanin e parë filozofik "Pse?" Disa nga këto paradigma krijuese erdhën për herë të parë në letërsinë shqipe. Kurrë më pas letërsia jonë nuk pati kaq larmi tematike dhe stilistike, kaq figura krijuesish me profile krejt të pangjasme me njëri-tjetrin, kaq individualitete të spikatura.

Ka gjithmonë një debat për krijimin letrar nën diktaturë; si do ta vlerësonit ju këtë krijimtari?

Letërsia nën diktaturë fillimisht erdhi si mohim i periudhës pararendëse. Në vitet '60 të shekullit që shkoi, mund të thuash që letërsia shqipe rilindi edhe një herë, si nga e para. Përtej programeve politike të detyruara dhe që u imponoheshin zyrtarisht shkrimtarëve, talentet i çanë barrierat dhe e afirmuan veten. Gjatë këaj kohe u shkruan cilësisht poezia, tregimi, romani. Do të thosha se proza e gjatë romanore për herë të parë në historinë e letërsisë shqiptare u konsolidua, arriti pjekurinë që kërkon kjo gjini derisa nëpërmjet përkthimeve filloi të konkurojë në tregjet e kulturës në botë.

Shkrimtarë si Petro Marko dhe Jakov Xoxa do të pasohen nga Ismail Kadareja, Dritëro Agolli, Fatos Arapi. Kadareja, Agolli, Arapi ka qenë një treshe individualitetesh që e përshkoi krejt kohën e letrave të një gjysmë shekulli me cilësitë e larta të fjalës së shkruar. Rreth tyre pati dhe shumë shkrimtarë të tjerë. Disa nga këta shkrimtarë e pasuruan talentin e tyre edhe në periudhën e pas '90-tës.

Në Kosovë shkrimtarë e poetë të rinj e afirmuan fjalën shqipe në një tjetër klimë politike. Shpejt shkrimtarë si Azem Shkreli, Ali Podrimja, Rahman Dedaj etj. do ta shohin veten të përkthyer në frëngjisht, gjermanisht, serbokroatisht. Proza u kulmua në cilësi nga Anton Pashku dhe Mehmet Kraja.

Në arbëreshët e Italisë, prapë në një klimë kulturore jashtë çdo marrëdhënieje me dheun e gjuhës që shkruanin, do të shquhen Dushko Vetmo, Vorea Ujko, Luka Perone, G. Skiro di Maggio...

Në diasporë shkruan e botuan studime, libra artistikë E. Koliqi, Martin Camaj, Arshi Pipa, I. Luzaj etj.

E para, letërsia shqipe e gjysmës së dytë të shekullit të 20-të do parë në tërë shtratin e vet, në Shqipëri, në Kosovë, në diasporë. Dhe e dyta, do parë në klimën politike dhe ideologjike kur u krijua.

Ishte një periudhë e dominuar nga lufta e ftohtë midis dy blloqeve. Shkrimtarët, piktorët, muzikantët u përdorën, u vunë në shërbim të politikës së brendshme të shteteve ku jetonin, por më të shquarit, u synua të përdoren dhe në plan global në përplasjen mes shteteve dhe mes dy blloqeve, Lindjes dhe Perëndimit. Zbardhja e dokumenteve sekrete të disa kancelerive perëndimore po dëshmojnë që artistët u përdorën nga politika e të dy anëve të Perdes së hekurt.

Duhet ta kuptojmë këtë situatë të pasqorë në

histori, situatë të përvetësimit të talentit artistik në luftën për pushtet. Çdo luftë ka viktimat e saj. Shkrimtarët që ia dolën, që mbijetuan, qoftë dhe me një pjesë të krijimtarisë, apo dhe me vepra të veçanta të tyre, përtej lëshimeve apo kompromiseve që u duhej... që ishin të detyruar t'i bënin, janë pasuri dhe i mbeten përgjithmonë fondit të kulturës sonë.

Po për krijimtarinë letrare të periudhës së demokracisë, ç'mund të thuhet?


Si periudhë është mbi një çerek shekulli. Nuk është pak. Por është periudhë depresioni. Periudha e pas Pavarësisë ishte e shoqëruar me frymën e krijimit të shtetit shqiptar. Besohej se vendi fshihte përbrenda energji magjike. Përparimi, mbrohtësia do të vinin, do të binin nga qielli. Vetëm Migjeni duket se qe esëll. Ai i vërejti lypësit, prostitutat, të degraduarit në dehje e në llum... vërejti se këtu, në këtë vend, po valonin flamujtë e melankolisë.

Fillimet e regjimit komunist kishin me vete propagandën, pompën e një fryme optimizmi. Zhgënjimi do të vinte më pas. Dhe kjo frymë zhgënjimi më nuk do të ndalej... deri më sot.

Fillimet e erës së demokracisë u shoqëruan me slloganin 'ky vend nuk bëhet'. Kjo frymë disfatiste u nxit dhe nga krijimet e shkrimtarëve e poetëve. Filluam t'u këndojmë humbjeve, zhgënjimeve si fat historik i shqiptarëve.

Shqipëria në vitet '30 të shekullit që shkoi, kur shqiptarët ishin mbi 80% analfabetë, kishte revista që drejtoheshin nga atë Gjergj Fishta, nga atë Zef Valentini, nga E. Koliqi, nga B. Merxhani etj. Këta burra të atëhershëm e lexonin njëri-tjetrin dhe menjëherë i jepnin vendin që i takonte secilit në rendin e vlerave. Në diktaturë kishte kritikë institucionale, gazeta e revista letrare me emër, ku po të botoje, e kishte siguruar vëmendjen e të tjerëve. Nuk ishin të përsosura gjërat, vareshin kryekëput nga politika, por vendosej një rend. Po ta lexonim një libër, pavarësisht qëndrimit zyrtar, e dinim ku e kishte vendin.

Letërsia e krijuar në këto vite mbetet në mëshirën e rrugës. Nuk e lexojnë profesorët e universiteteve tona të shumta. Dhe shkrimtarët rrezik se e lexojnë njëri-tjetrin. Nuk ka as klimën



e viteve '60 '70 kur ne ia lexonim në xhep poezitë njëri-tjetrit. As klimën e atyre burrave të viteve '30 si Koliqi që e zbuloi dhe promovoi menjëherë në revistën e tij një talent si Migjeni.

Sot ka suplemente gazetash, klube e klane sektare që nuk përbëjnë vlerë përtej meskinitetit të vetes

A ka letërsi? Po. Ka prurje letrare që duhen shënuar si suksese dhe si vazhdimësi e një letërsie me traditë të qëndrueshme. Kjo është njëra anë.

Ana tjetër: ka kaos në botime. Cildo që ka pesë lekë e boton një libër, e paguan dhe një kritik që t'ia promovojë librin. Ka botues spekulantë që u bëjnë marketing librave dhe letrarëve që bien nëpër panairë si gjethet e vjeshtës. Këta shkrimtarë të shquar panairësh, e shumta mund të jenë publicistë me para të madhe nëpër xhepa që u ka shkrepuar në kokë që të promovohen edhe si letrarë. Këta me paratë dhe influencat manipulojnë mediat, publikojnë shifra të stërzmaduara të shitjeve në treg.

Brezi i krijuesve seriozë të këtyre viteve, pas kaq dekadash, me përvojën e hidhur që ka, duhet t'i dalë për zot vetes. Duhet të dijë të vendosë rend në kaosin që ngjan se nuk do të ndalet.


Gjuha shqipe është nga pasuritë më të mëdha të kulturës shqiptare. Një vlerë planetare, gjuhë me rëndësi universale, pasuri e gjithë njerezimit. Të ngjan se po e shtojmë pak më shumë nga ç'është vlerën e gjuhës shqipe. Aspak.

Gjuha shqipe është ndër 6-7 gjuhët më themelore të njerëzimit, të familjes indoeuropiane. Bashkë me greqishten dhe armenishten janë tri degë më vete në pemën e gjuhëve të familjes indoeuropiane.

Shqipja me kohë ka tërhequr vëmendjen autoriteteve shkencore në botë. Kur shteti shqiptar nuk ekzistonte, Gustav Mejeri hartoi fjalorin e parë etimologjik të shqipes (1891). Libri i prof. Rexhep Ismajlit "Studime për historinë e shqipes në kontekst ballkanik", Prishtinë, 2015, tërheq vëmendjen edhe për atë që studimet mbi historinë e gjuhës shqipe luajnë një rol kyç për të përcaktuar formimin, prejardhjen dhe vendin që zënë në histori gjuhët e tjera të Ballkanit. Në Tiranë studimet kanë mbetur në një gropë të zbrazët me largimet nga jeta të brezit të linguistëve të shquar shqiptarë. Sivjet u larguan nga jeta tre albanologë me emër ndërkombëtar, kanadezi Robert Elsie, amerikan profesor emeritus Eric P. Hamp dhe gjermani profesor Wilfried Fiedler. Një etimolog rus Vladimir Orel ka lënë një gramatikë historike dhe një 'Fjalor etimologjik' të gjuhës shqipe. Këta janë shkencëtarë të mëdhenj që kanë punuar për guhën tonë pa asnjë vëmendje nga shteti shqiptar. Të paktën, të përkthehet, të botohet dhe të promovohet krijimtaria e tyre.

Libri juaj studimor për "Disidentët e rremë" kaloi në heshtje dhe nuk mori vëmendjen e duhur, a mund të thuhet se e sotmja ka shumë pengje nga e shkuara jonë jo shumë e largët?

Në atë libër kam tërhequr vëmendjen për pompimin si disidentë të disa figurave me prejardhje nga radhët e Sigurimit të shtetit. Me dokumente arkivore rrëzova mitin e rremë të Kasëm Trebeshinës disident, një ish-kapiten dhe themelues i Sigurimit të Shtetit që në vitin 1945, hartues gjoja dhe i një promemorjeje kundër realizmit socialist. Ajo promemorje nuk ekziston në asnjë dokument. Ishte një falsifikim publik që zuri vend në



tekstet akademike dhe në ato shkollore. Ata që e kishin shpallur atë 'Promemorje', pas botimit të librit "Disidentët e rremë", nuk e mbrojtën dot, nuk vërtetuan që ajo ka ekzistuar ndonjëherë.

E kaluara jonë nën diktaturë fsheh shumë pengje. Shumë të zeza që nuk do të zbardhen kurrë. Ata që i bënë ato të zeza, shpejt lanë duart dhe, pa asnjë pendesë, pa asnjë katarsis u kthyen në krye të punëve. Ajo që u quajt Katovica është zbatuar pikë për pikë në të quajturën demokraci. Libri "Disidentët e rremë" nuk mund të pritej mirë në këtë klimë të shumë deformimeve të kobshme të mbuluara përsipër me pak pudër të bardhë. Libri "Disidentët e rremë" zbulonte ca të vërteta të hidhura, si ajo që një vrasës i dy partizanëve në luftë, e shpalte veten hero, disident, shkrimtar i shquar.

Jo vetëm në Shqipëri, në Europë dhe më gjerë, më shumë se 90 për qind e letërsisë është mediokre, konsumiste, që shfaqet aty për aty dhe zhduket pa lënë gjurmë; pse ndodh kjo dukuri?

Ky fenomen gjithmonë ka ndodhur. Vetëm midis këtyre llozhrave pa fund, lindin ca fare pak vepra që mbeten të pavdekshme. Ai që do të nxjerrë nga nëntoka një grusht flori, për të hapur tunelin do



të lëvizë një mal me gurë e baltë. Sot me rritjen e shtypshkronave, me rritjen e numrit të atyre që shkruajnë sa që çdo shtëpi e ka një shkrimtar, kjo dukuri do të jetë e denjë për një situatë të çmendurisë kolektive. Nuk e di se si mund t'i vihet fre.

Ka dy mendime për letërsinë shqipe: e para që e rendit atë me krijimtarinë më të madhe europiane dhe botërore dhe e dyta që e nënvleftëson atë; mendimi juaj?

Letërsia shqipe në gjysmën e dytë të shekullit të njëzetë, doli nga provincializmi. Librat e Kadaresë i gjen në libraritë e qyteteve më të mëdha, i gjen dhe në katedrat e Universiteteve kudo në të pesë kontinentet. Si shkrimtar shqiptar, po të ndodhi që të jesh i ftuar në një aktivitet letrar ndërkombëtar pranë ndonjë univërsiteti si: në Tokio, në Seul a në Buenos Aires, menjëherë studentët e atyshëm do të të rrethojnë që të mbash një konferencë, do të të mbulojnë me pyetje për letërsinë e Kadaresë, për letërsinë, për gjuhën shqipe etj. Sot për sot, asnjë nga popujt e Ballkanit, për të mos shkuar më tej, nuk e ka një shkrimtar me kaq emër sa Kadareja. Romanet e tij u rekomandohen për lexim të detyruar studentëve në universitete. Ato hyjnë në fondin e letërsisë më të mirë të kohës sonë. Siç e thashë më lart, letërsia shqipe është përtej provincializmit jo vetëm me Kadarenë. Shumë shkrimtarë e poetë e shohin veten të përkthyer e të afishuar në stendat e panairëve në botë, botohen në antologji, promovohen në revista të rangut ndërkombëtar. Mbase nuk është vendi për mburrje, por as nihilistë për vlerat tona nuk kemi pse të jemi.

Si një nga miqtë më jetëgjatë të Kadaresë dhe si autor i disa eseve rreth tij, ç'mund të thoni për të teska për vitet 2019-2020 është fitues i dy çmimeve të rëndësishme ndërkombëtare, një në botën aziatike dhe tjetrin të quajtur "Nobeli amerikan"?

Për mua nuk përbën çudi marrja e çdo çmimi ndërkombëtar prej Kadaresë. Dhe prapë janë të gëzueshme ditët kur merr lajme të tilla.

Vjet u botuan në SHBA dhe u pritën shumë mirë esetë dhe romanet "Kamarja e tradhtarit" dhe "Muzgu i perëndive të stepës", romane që tek ne ishin botuar në mesin e viteve '70. Botimet me sukses në SHBA të romaneve të dyzet vjetëve më parë, vërtetojnë atë që letërsia e tij del e fituar në betejën me kohën.

Ai është shkrimtar me vlera të qëndrueshme si rrallë nga ata që kanë zënë vend në historinë e letërsisë. E kam ligjëruar në Universitet të lëndën e letërsisë botërore dhe e di fort mirë sesa e vështirë është për një shkrimtar të ruajë ritmin e botimeve dhe të jetë përherë në nivelin e tij më të mirë cilësor e tematik. Kadareja me pasurinë dhe gjerësinë e talentit, me disiplinën krijuese ka pasur ndër vite një performancë të përkryer botimesh.

Ky ritëm si i atij lumit që i përcjell pandalur ujërat drejt detit, e ka mbajtur Kadarenë në atë nivel që profesor Xhon Kerri i çmimit 'Man Booker' e quajti titan që mundi titanët. Prej 40 vjetësh është në listën e më të mirëve në kandidatët për Nobelin. Ka korrur çmimet më të mëdha në Europë, tani dhe në Amerikë, dhe në Azi.

Ai është një pasuri e gjuhës sonë. Jo vetëm kaq. Koha po provon se vepra e tij më e mirë është pasuri për njerëzimin.

SIMFONIA E SHENJTË

(Kushtuar piktorit Zef Kolombi)

Nga HYJNI CEKA

Sa qasej dreka, zinin kabanat e binin, nëpër kisha... Ia thoshte edhe myezini lart, në minare, te Xhamia-Mbret...

Atë kohë, dilja në prag të derës së madhe. Kisha qejf të shihja profesor Zefin, kur shkante rrugës. Gjithnjë, po në një kohë, më kalonte përballë. Me hap të gjatë... Trupit i jepte përpara.

Sokaku ynë zgjatej e zgjatej. Më dukej pa fund. Por, mbyllej larg... Te sergjet e Paparistos...

Pak përpara, më të mëngjër, çelej një rrugicë. Gjithë-gjithë, njëqind metra kalldrëm. Andej banonte dhe profesori: Rruga Papa-Mihalej.

Thoshin që kishte grua të bukur dhe djalë të vetëm. Unë... s'kisha parë gjë. Po, kur shihja sa e zgjaste hapin për shtëpi, mendoja veç një gjë... Sa fort i donte profesori atë grua dhe atë djalë!..

Për Zef Kolombin flitej shumë nëpër Elbasan... Për të mirë, sigurisht. Tregonin se, po të kthehej nga puna, mbyllej. S'dilte më nëpër qytet. Merrej... veç me grua e veç me djalë...

Tregonin edhe për shtëpinë. Muret e dhomave i kishte zbkuruar, cep më cep, me piktura. Portrete të gruas, portrete të djalit... S'më besohej gjithë kjo. Mgaqë s'më arrinte gjer këtu mendja...

... Asi kohe, isha mbushur pa mbushur shtatë vjeçët. As në shkollë që veja. Ç'ish nderimi im për Zef Kolombin, përpara atij të mbarë qytetit!

E adhuronin.

Vendosi njëherë kavaletin nga Porta e Kalasë... Këndej nga futeshe për në lagjen tonë. Kalimtarët, sa e shihnin, mënjanonin. Anash e anash... Rrëzë muresh... Maja gishtash... Si e si të mos shqetësohej artisti... Të pikturonte i çliruar. Ta ngjeshte penelin i frymëzuar...

Shkoi një copë herë kështu.

Pastaj vinin njerëzia te Porta e Kalasë. Ndalnin aty. Shihnin piktorin nga larg... I binin rreth e përçark ahëre. Gjëkund se pipëtinte zë!

... Në të hyrë të Portës ishte rrojtoria e Liçit.

-Ç'bëhet kështu?!-habit Liç Berberi. -M'u shkretua dyqani.

I thanë me zë të ulët:

-Ka dalë zotni Kolombi .. Pikturon faqen e Ullishtës.

Dajë Liçi zbriti. Ashtu, me pantofla... Gjeti edhe shkak... T'ia mbante për shtëpi njëherë.

Drejt... Ku qe ngulur Zef Kolombi. Mes dyerve të Ali Cungut e të Met Mirakut.

Piktori, atë kohë, zhytur në mjegull frymëzimi. Sytë i pat qepur larg fare. Mbi faqe të Ullishtës... Shihte dhe kabanoret, dhe xhaminë, fare pranë.

Cigarja i varej. Kish harruar ta thithte.

Liç Berberi nga buzët nxirrte mjaltë.

-Të lumtë ajo mendje, profesor!.. Të lumshin ato duar!

Ai se si ktheu... E falënderoi.

I qenë ngjitur të dy kavaletit... veç ata.

-Oh, ç'nder!.. Po na nxjerrke lagjen! Ti je "xhanan", profesor!

Zef Kolombi mezi u shkëput prej vetvetes.

-Jo, zoti Ali!... Po krijoj tablonë e "Simfonisë së Shenjtë"... S'e sheh? Vijnë njëri pas tjetrit. Minarja, kabanorja e Shën Marisë dhe ajo e Shën Pavlit përtej... Ullishta në sfond... Paqe e tëra.

Në lagje tre besime, vëllazëruar!

Liçi u befusua. Si i verbëri kur i shkrep, papandehur, drita e syve...

-Bah!-shpërtheu... Dhe heshti e ra në mendime.

Kaq vite që mbante rrojtoren "Normalisti", te Gryka e Kalasë! Kaq vite që priti e përcolli sa e sa profesorë!... Kaq vite që shkoi nëpër duar mendjet më të ndritura të Shqipërisë!... Kurrkush nuk ia pat thënë atë fjalë... Vjen shkodrani, prej anës e anës, e ia thotë. Ku t'i gjesh këta njerëz, more!.. Ta dojë tjetri Elbasanin, si ta ketë vatrën e tij!... Të bëhet dhëndërr në këtë qytet!... Ta pikturojë!... Ta zbkurojë!... Ta lulëzojë!...

-Më lër të përçafoj, o zoti profesor!

U shtrënguan qafë e për qafë. Si motit... Herë më një krah, herë në krahun tjetër...

Si u ndanë, berberi u lut përsëri:


-Lërmë t'i puth ato duar, të paktën!

-Jo, zoti Ali!.. Të kam në vend të babait.

-Or, po do t'i puth se flori i paske!... Flori!...

Dhe ia puthi vërtet.

Gjithë këtë jo se e krijoj... Por e kuptoj... Se më ka qenë ngulur në mendje që nga kohëra-thellë. Bëhen shtatëdhjetë vite. Ndoshta edhe më tepër. Më mbetet peng veç për një gjë. Si nuk u bë i gjallë një elbasanas e të kish thënë dy fjalë për Zef Kolombin?! I kemi hyrë



Zef Kolombi, *Autoportret*, (vaj) 1947

në hak. Jo se u shkri për Elbasanin... Por u shkri me këtë qytet... Bashkë! Elbasanas, njëzet e katër karat!

E pat marrë mbarë... Nga s'e nguli atë kavalet të uruar! Në Qoshe, te Gjirizi, ballë për ballë me Shkëmbin e Letanit... Në Tabake, te Çardhaku, përballë me Krastën e Madhe... Te Gjurma e Mushkës... Tek Tri urat. Nëpër tablo e mbodhi gjithë. Që nga Ullishta e deri buzë Shkumbini.

Kush e bëri këtë?... S'e bëri djali yt, o Elbasan! Por Zef Kolombi.

Qasej pranvera nga fundi i shkurtit... Merrte për krahun gruan, djalin për dore, pasdrekeve, nisej Arave të Gjata, rrugës së Shën Thanasit. Bridhte çarjeve e futej gëmushave. Mblidhte lule behari deri sa errej.

Kthehej e përzihej me vargun e shtëtitësve... Me tufa manushaqesh nëpër duar... Me tufa karakafesh...

Për Ditë Vere rrihte ballakume. Bënte qoka, si gjithë elbasanasit, çonte dhe djalin "për kamë", në shtëpinë e vjehrrës...

Ngjitej pastaj te Rrapi i Mansit, bashkohej me pelegrinazhin. Njerëzit, dhe ulur të ishin, çoheshin në këmbë. Viheshin në rresht, të nderonin profesorin. Kolombin e Madh!

Ai përkëdhelte të vegjlit dhe tokej me të rriturit... Uronte për Ditë Vere...

... Mori zakonet tona të sjelljes. U miqësua me ortodoksë e muhamedanë. S'do mend. Me të diturit, sojin e vet. Nuk vinte re për sekte fetare.

Afronin Pashkët e Mëdha, bënte si gjithë lagjia... Ngjyroste vezë. Ndante "koqeve të kuqe" e "kuleçë" nëpër dyer myslimane. Nxirrte Julin me kanistër. Radhë i merrte dyert e profesorëve. Gostiste për festën e të krishterëve.

Vinin pastaj ditë me shenjë e të shenjtëruara. Kishim Shën Gjonin pranë, Teqenë e Madhe... Ç'të numëroj tjetër?! Zef Kolombi bënte respekt për festa fetare. Ndiqte shartet, me përpikmëri, si gjithë elbasanasit.

Kur shkante për Shën Gjon Vladimir, e kish caktuar poltronën, ngjit dhespotit e kryepeshkopit... Ama, dhe ai dinte të nderonte. Mot për mot nga një ikonë dërgonte. E ndriste ikonostasin me pikturën e tij.

Që kohë e shenjtë ajo e atyre viteve. Elbasani, me besë në Zot. Të "mençmit e dheut" këtu qenë mbledhur... Lef Nosi e Sotir Kolea.

Dhe Zef Kolombi po mes tyre!

Më tej... S'i eci më. Një mijë e nëntëqind e tridhjetë e teta ka qenë... Kohë dimrash, me rrebeshe. Binte shi rrusgjërë!

Atë mot vdiq gruaja e Zefit, Liria... I gjithë Elbasani nxiu. U mbyll Normalja. U mbyll pazari, si nuk pat ngjarë ndonjëherë. U shkull njerëzia, u dynd nëpër rrugët e "Kalasë", te Papa-Mihalët. Po si nuk u ndal një çast si shi?!... Qanin qiejt... Vajtonin Lirinë, gruan e Zef Kolombit. Myslimanë e të krishterë, ç'pat Elbasani, mbanin qirinj për përshtirje... Si nxinte kisha njerëzit.

Rrugës për në varreza, në ballë u vu banda "Aferdita"... Me "Rekuimet" e Bethovenit e kanë përcjellë të ndërën Liri.

Kohë më vonë, Zefi ngriti mbi varr të së shoqes një mauzole-lapidar: "Simfoni e Shenjtë". Rreth e rreth me zinxhirë të rëndë...

Kolombi s'e çoi më kokën.

Lapidari atje gjendet. Shenjtëron mes varrezave, siç e ndreqi Zefi...

... Me duart e veta.

Dy shkrimtarë, dy botë asimetrike: *P. Marko dhe E. Hemingway*

nga Virion Graçi



Portreti nga Ina Lajthia

Për shkak të skualifikimit politik të Petro Markos në periudhën e totalitariste 1950-'90, qëndrimi i kritikës zyrtare dhe institucioneve të kulturës ndaj krijimtarisë së tij, në rastet më afirmative ka qenë i cunguar, minimalist; rëndom mbi autorin kanë mbizotëruar ato që Prof. A. Plasari, saktësisht i ka quajtur së fundmi 'burgjet e padeklaruar të P. Markos...'

P. Marko, pas traditës tepër modeste e modeleve rrëfimore anakroniko-anemike të romanit shqip deri atëherë, vitalizoi rrëfimin epik, dëshmoi siguri artistike e mjeshtëri; la modele në disa lloje letrare: "Hasta la vista" dhe "Qyteti i fundit," - në historinë e romanit modern shqiptar; "Shpella e piratëve," - në letërsinë për fëmijë; "Intervistë me vetveten, retë dhe gurët," - në letërsinë memuaristike-autobiografike.

Për të vijuar, duhet një parantezë: tekstet romanore të P. Markos, i janë nënshtuar diktatit të ashpër redaksional, për pasojë janë tjetërsuar. Kanë ndërhyrë në titujt, duke i rekomanduar lexuesit konotacione të tjera ideo-emocionale, ndryshe nga konceptimi autorial; kanë dërguar në brumatriçet e letrës libra të porsabotuar; kanë ndërhyrë në brendinë e veprës duke tjetërsuar personazhe protagonist, duke shfytëruar natyrën e marrdhënieve midis tyre. Shembull arbitrar i bashkautorësisë sterilizuese autor/redaksi, është dhe diskutimi në redaksinë përkatëse i *Hasta la vista* për dashurinë midis Gorit dhe Anitës... Në një rast tjetër, kritika gjenetike e tekstit, nëse mund të gjenden

variantet origjinale të autorit, mund të ndriçojë shumë aspekte duke iu qasur romanit të autorit dhe jo romaneve redaksionale, sikurse jemi detyruar deri më sot t'i marrim në studim romanet e gjymtuar të P. Markos.

...Sikurse premtuam në titullin e këtyre shënimeve, do të përpiqemi ta shohim P. Markon krahasuar me një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë amerikane dhe botërore, Ernest Heminguej. Krahasimi bëhet i arsyetuar sepse P. Marko ka pohuar mëse një herë se për *Hasta la vista* është frymëzuar nga *Për kë bie kambana*; fabula e njëjtit historike, etj... **Tipologjitë e romaneve:** Për nga poetika romanet i përkasin realizmit klasik, *balzakian*; kanë ekspozicione të hollësishme e konkrete për personat veprues, për vendin e zhvillimit të ndodhisë romanore, për konfliktet bazë të protagonistëve letrarë. Personazhet përshkruhen vizualisht e së jashtëmi e pastaj psikologjikisht; skenat e ngjarjeve përshkruhen me hollësi, pa e larguar nga vëmendja njeriun, problematikën sociale. Dialogët, përshkrimet e jashtme, ndryshimet e pikëshikimeve rrëfimore janë të drejta, porporcionalisht dhe në gjurmët e arritjeve më të mira të romanit realist.

Për traditën e vobekët të romanit shqiptar aso kohe, një model i tillë si *Hasta la vista*, ishte gjithësesi piknisje e mirë, shkollë e re narrative. Nga ana tjetër, edhe Heminguej, përfaqësues i madh, i zëshëm i një tradite të shquar letrare, njohës i arritjeve të mëdha të


romanit modern duke filluar nga Xhejms Xhojsi e duke vazhduar me të tjerë romancierë të mëdhej e novatorë, ka pëlqyer teknika më të thjeshta rrëfimi duke shmangur përsiatjet e thella filozofike, monologun e brendshëm, rrjedhën e përroit psikologjik...Te *Për kë bie kambana*, Heminguej nuk zgjedh të përdor as disa nga arritjet e tij më origjinale të dëshmuara në vepra të mëherëshme: gjuha sugjестive, nënkuptuese e dialogut, konotacionet simbolike të pamjeve natyrore dhe epilogun e papërfunduar të fabulës, fundin e *pashkruar*. Brendinë e pasur e të trazuar të Robert Xhordan, e bën të dukshme nëpërmjet dialogimit të qartë të protagonistit me vetveten, situatë përshkrimore e tipit: R. Xhordan i tha vetes së tij..., kurse vetja e tij i tha R. Xhordanit...

Në këtë plan të dy romanet nuk paraqesin disnivele, autorët dëshmojnë të njëjtën siguri, natyrshmëri dhe efikasitet të mjeshtërisë artistike. Meqë jemi të karakterizimet sipas poetikave, në letërsinë tonë, *Hasta la vista* plotëson kriteret për t'u numëruar në radhë të parë si roman historik, si një arritje - model i romanit historik: ngjarjet janë të tilla, historikisht të njohura e të dalluara, po ashtu shumica e personazheve, po ashtu pozicionimi i autorit: i gjithë pranishëm por edhe gjithëpërfshirës, me tone të matura e të përpikta në rrëfim. Mbetet për historianët e letërsisë nëse do të mund t'i japin Petro Markos vendin e duhur, përpara S. Godos, S. Spasses, S. Krasniqit.

Dallime: Në parametrat formalë, strukturorë e narrative dy romanet dëshmojnë thjeshtësi, saktësi dhe përkryereje funksionale. Por veprat nuk kanë të njëjtin densitet lëndor, të njëjtën forcë shprehëse në pikat më nervalgjike përkatëse, të heronjtë qëndrorë. Protagonistët e P. Markos kanë pak relief psikologjik, pak domethënie sociale e humane krahasuar me heronjtë e Heminguejit. Qysh në epigrafet, autorët shpalosin synime të ndryshme, P. Marko premtun një roman homazh për vullnetarët shqiptarë në Spanjë; Hemingueji zotohet të shtjellojë në prozë një tezë poetiko-filozofike të poetit Xhon Don, zotohet për të dhënë një rrëfim për ndërthurjen tragjike të fatit të secilit njeri me gjithë gjindjen njerëzore:

"Askush nuk është një ishull më vete; çdo njeri është pjesë e kontinentit, një copë e së njëjtës tokë...Vdekja e çdo njeriu më pakëson edhe mua, sepse unë jam pjesë e njerëzimit dhe kështu askush nuk mund ta dijë me siguri për kë bie kambana: ajo mund të bjerë edhe për ty."

Heminguej e përdor si rast luftën e Spanjës, e shfrytëzon atë si përvojë monumentale për të bërë zbulimet e veta rreth natyrave njerëzore. Ai nuk ka dy lloj të vlarësh: - *dëshmorët, tanët*, nga njëra anë dhe *të tjerët, armiqët*, nga ana tjetër, sikurse premtohet në epigraf dhe realizohet bardh e zi, në mënyrë pllakateske të P. Marko.



Hemingueji me këtë vepër nuk është në kulmin e tij si autor; letërsia amerikane e asaj dekade mbizotërohet nga Folkner. Megjithatë vërehen te Robert Xhordan, tipare të autorit dhe të idealeve të tij jetësore. Është variacioni i të njëjtit model i mishëruar mjeshtërisht në vepra të mëherëshme, që kulmon sërish në epilogun e krijimtarisë së Heminguejit, te *Plaku dhe deti* me peshkatarin Santiago.


Heroi i romanit tjetër, Gori Gjinleka mbetet një personazh në rrugë pa krye, i pa formuar si individualitet. Ka dalë vullnetar për t'u përzjerë në një ngjarje me rëndësi kontinentale me padijen e theksuar, të gjithanëshme ndaj botës së madhe. Bota për të ka vetëm shokë komunistë dhe falangistë, borgjezë-armiq, dhe proletarë - vëllezër. Ai nuk evoluon mendërisht, vetëm sa i dhurohet hap pas hapi utopisë internacional-komuniste dhe dorëzimit të qenies së tij në duart e prijësive të lëvizjes revolucionare. Te personazhi Gjinleka ka nisur të kristalizohet tipari thelbësor i turmave, nënshtrimi i sinqertë ndaj eprorëve, kulti për prijësin - komandant, adhurimi i verbër për grupin e tij politik. Kulti i profesor Tomorrit, kulti i komisarëve komunistë në përgjithësi, është maket i asaj idolatrie nënshtruese dhe magjepsjeje të masave ndaj udhëheqjes së lartë komuniste që do të kulmonte në Shqipëri pas viteve kur shkruhej *Hasta la vista*. Indoktrinimi, dogmatizmi dhe cektësia filozofiko-politike nuk janë attribute të karakterizimit të ndërgjegjshëm estetik të heroit prej autorit, por janë cilësi, kufizime të imponuara të vetë autorit, shtuar sigurisht nga presioni redaksional, autocensura, recetat krijuese në fuqi. Në vitet '30-të kur zhvillohet fabula historike, megjithëse elementët e parë komunistë ishin të organizuar në grupe e celula, janë të pamendueshme autoritete kaq madhore drejtuese midis tyre që të përthithin gjithë nderimet, adhurimin, brenditë shpirtërore të shokëve të thjeshtë sikurse del në roman.

Pabarazitë e sipër përmendura janë pasqyrë e formimit kulturor e letrar të dy autorëve, por, po aq, janë pasojë e pabarazive midis mjedisve kulturorë-politikë përkatës. Për Heminguejn mund të mjaftohemi me vlerësimin e një prej kritikëve më të ashpër të tij, Paul Johnson:

"Heminguej, mbi të gjitha ishte një shkrimtar thellësisht origjinal që diti të transformojë vetë mënyrën e të shprehurit të bashkëkombësve të tij dhe të gjithë botës anglofone. Veç kësaj krijoi një stil të ri etik, laik dhe jashtëzakonisht modern, që, megjithëse kishte rrënjë të forta amerikane, u përkthye lehtësisht në shumë kultura të tjera. Hemingueji shkriu bashkë karaktere të ndryshme amerikane duke u personifikuar si arketip i tyre dhe për këtë u konsiderua simbol i Amerikës së kohës së tij, pak a shumë si Volteri për Francën e viteve 1750 dhe Bajroni për Anglinë e viteve 1820."


Talenti i lindur, perfeksionizmi stilistik dhe jeta e mbushur me eksperiencë të jashtëzakonshme, janë tipare që e kanë shquar Heminguejin. Por do të shtonim se ai ishte një lexues i jashtëzakonshëm. Qysh herët kish lexuar e analizuar gjithçka të bukur që ishte krijuar në vendin e tij, në Europë e në Rusi në lëmin e letërsisë, arteve dhe filozofisë. Bartës i kësaj pasurie të madhe Heminguej vendos të mos shkruajë i mbështetur mbi traditën por kundër saj, radikalisht novator, original dhe i lexueshëm.

Nga ana tjetër, në formimin e P. Markos, rol të parë mbetet të ketë libri i gjallë i jetës, deri në 1944; mbas kësaj, sinkronizimi i tij, pasurimi me kulturën perëndimore, zhvillimi i natyrshëm intelektual bëhet realisht i pamundur. Përvoja e tij si pjesëmarrës e dëshmitar ngjarjesh të



mëdha, në vend të jetë epërsi si lëndë e parë për shprehje madhore letrare, shndërrohet në kufizim, në fatkeqësi, motiv i fortë heshtjeje dhe kamuflimi. Debutimet e para, të suksesshme e premtuese të P. Markos në lëmin e romanit, nuk përshëndeten por bëhen shkak përndjekjeje e dhune të gjithanëshme, të gjithëllojshme. E kundërta ndodh për Heminguejin: fillimet e tij letrare e frymëzojnë Ezra Paundin aq sa ky, me shënimin: "Shkruan vargje të shkëlqyera dhe në prozë është shkrimtari më i talentuar stilistikisht," influencon fort e ndërmjetëson te botuesi Ford Madoks Ford duke ia hapur rrugën për sukses letrarit të ri. (Hemingueji ia ruan mirënjohjen poetit të madh duke e shpëtuar vite më vonë nga dënimi me vdekje.)

Duke parë rrethanat konkrete *ku e si* kanë jetuar e krijuar Hemingueji dhe P. Marko, mund t'i pohojmë pabarazitë midis dy autorëve, nëpërmjet veprave të tyre, si rrjedhime të kulturave përkatëse. Tradita kulturore nuk mund t'i ofronte më shumë talentit P. Marko; për horizontin kulturor të Shqipërisë së



asaj kohe, lindja, botimi dhe prania në librari e një veprë si *Për kë bie kambana*, ishte e panevojshme, e padëshirueshme. Edhe në dekadat që pasuan, një krijimtari e përmasave të Heminguejit, ishte e ndaluar, ligjërisht e dënueshme. Nuk është pa domethënie fakti se - si libër i plotë, romani në fjalë i Heminguejit i erdhi lexuesit shqiptar vetëm në v.2002

Autori shqiptar P. Marko ka mund t'i asimilojë me origjinalitet të theksuar kujtimet e tij nga lufta në Spanjë, ashtu dhe shprehjen e letrarizuar romanore për këtë bashkëpërvijë, ofruar prej një mjeshtëri si Heminguej. Nga ndikimet e Heminguejit te Marko, përveç shkëndijës frymëzuese për të shkruar rreth kësaj teme, njëra linjë veprimi është e dukshme: episodi me kurbatkat, me femrat e maskuara si kurbatka. Motivi i kurbatkave të vërteta, motivi i ciganeve, i ndeshur disa herë te Hemingueji në kuadër të një sfondi realist-mesdhetar, shtegëton te romani i P. Markos dhe zhvillohet bukur. Nëpërmjet ligjëritimit të tyre të poetizuar, mistik e ezopik, autori i shton veprës një përmasë të re të leximit të fatit njerëzor si tragjik, absurd dhe delikat. Me episodet e kurbatkave, P. Marko ka mundur t'i ikë vigjilencës së censurës dhe bashkautorësisë së pakëndshme, vrastare me...redaksinë. Këto episode dhe tregimi i gjatë për Xhemalin, peripecitë deri në Francë dhe fundi i tij, janë pjesët më të arrira të veprës. **Si përfundim:** Mjedisi kulturor, social e politik me mundësitë, lehtësitë, apo dhe pamundësitë e shprehjes së lirë, në kuptimin e gjithanshëm të konceptit *liri*, kanë luajtur rol përcaktues në fatin përfundimtar të shkrimtarëve. Nuk ishin përkatësitë politike ato që cënuan njërin dhe favorizuan tjetrin: Heminguej, i endur në ato vite midis ideve socialiste dhe komunistëve, ishte rreshtuar me komunistët në kohën e shkrimit të veprës. Anësinë politike nuk e shprehu nëpërmjet romanit, të cilin e kish shkruar qysh gjatë luftës civile, por duke pritur ta botonte romanin kur lufta kish mbaruar, i vetëdijshëm se nuk i nxirrte aspak në dritë pozitive republikanët e tij, përkundrazi.

Dallim paradoksal bëjnë paragjykimet e veprave duke pasur si masë biografitë e autorëve. Jeta e Heminguejit ishte e bujshme, me ngjarje të dhunshme, të shëmtuara dhe skandaloze, dhe po ta vlerësosh me parametrat amerikanë të moralit e të etikës; shfaqet e tij publike, përfshirjet e tij në problemet e ndryshme shoqërore jo rrallë ishin aventureske, qesharake, me pasoja të rënda, të pakëndshme për njerëzit që i rrinin pranë. P. Marko, me një jetë të paqme e të përvuajtur, ishte dukshëm më lart në vlera njerëzore krahasuar me njeriun - Heminguej. Por tradita e shëndoshë e letërsisë amerikane dhe asaj perëndimore që e kërkojnë pasurimin dhe vijimësinë të thyerjet rindërtuese dhe të kundërshtitë e qarta rinovuese, origjinale, e mirëpriti në fronin e nderit dhe i dha Heminguejit atë vend që i takonte si shkrimtar i madh. Kultura jonë tradicionaliste që e sheh të garantuar vijimësinë e saj kryesisht nëpërmjet përsëritjeve epigonale, nëpërmjet oportuniteteve estetiko-stilistikore dhe zyrtarizimit të standardeve vlerësuese, e pamundësoi realizmin e P. Markos si letrar në ato përmasa që ka pasur dhuntinë. Kurse vlerën e tij letrare - artistike e çmuan me kutin e njohur tashmë për servilizëm kronik, duke u nisur së pari nga vendi që i jepte sistemi politik-shtetëror njeriut P. Marko, e mandej, duke i hedhur ndonjë sy veprës së tij të gjymtuar.

NJË SHTËPI E QETË

tregime nga Marie Luise Kaschnitz


NJË SHTËPI E QETË

Shtëpi e qetë, thatë? Tani po që është shtëpi e qetë, por deri pak më parë ishte skëterrë. Sipër dhe poshtë nesh jetojnë familje me fëmijë të vegjël. Veç t'i përfytyroni ulërimat dhe të bërtiturat, grindjet, përplasjet dhe gërvishtjet e këmbëve të vogla, të inatosura! Fillimisht goditnim me bishtin e fshesës në dysheme dhe në tavan. Kur kjo nuk bënte punë, im shoq i binte telefonit.

-Po, na falni, - thoshin prindërit, - të voglës po i dalin dhëmbët; binjakët po mësojnë të ecin.

Sigurisht që ne nuk kënaqeshim me justifikime të tilla. Im shoq u ankua tek administratori i godinës; një ankesë çdo javë, pastaj u mbush kupa. Qiradhënësi u shkroi letra atyre sipër dhe atyre poshtë dhe i kërcënoi me prishjen e menjëhershme të kontratës. Fill pas kësaj gjendja u përmirësua. Banesat këtu nuk janë edhe aq të shtrenjta dhe çiftet e reja nuk kanë para për t'u shpërngulur. Si i bënë fëmijët të rrinin urtë? Epo, nuk e di me saktësi. Besoj se tani i lidhin te këmbët e krevatit, kështu që veç mund të zvarriten dhe normal që bëjnë më pak zhurmë. Ndoshta marrin qetësues të fortë. Nuk ulërijnë dhe nuk bërtasin më, por gugatin me vete, me zë fare të ulët, si në gjumë. Tani i përshëndesim sërish prindërit tek i ndeshim nëpër shkallë. Madje i pyesim: Si janë fëmijët?

-Mirë, - thonë prindërit. Por nuk e di se përse këtë fjalë na e thonë me lot në sy.



Marie Luise Kaschnitz u lind në vitin 1901 në Karlsruhe. Tregimet e para të saj u shfaqën në vitin 1930. Në vitin 1933 boton Romanin "Fillimi i dashurisë"

Shkrimet nga viti 1937 e deri pas Luftës së Dytë Botërore botohen pas vdekjes, në vëllimet: "Këngë nga jeta njerëzore" dhe "Kopshti i vjetër".

Në vitin 1951 boton "Fëmija i shëndoshë dhe tregime të tjera".

Në vitin 1952 boton "Zëra të huaj"

Në vitin 1955 merr çmimin "Georg Büchner".

Në vitin 1958 merr çmimin letrar "Immermann".

Në vitin 1964 merr çmimin letrar "Georg Mackensen".

Në vitin 1965 bëhet anëtare e Akademisë Bavareze të Arteve të Bukura, Mynih.

Në vitin 1968 shpallet "Doktor nderi" i Universitetit të Frankfurtit.

Në vitin 1970 nderohet me çmimin "Hebel". Martesa me arkeologun e shquar Guido von Kaschnitz dhe udhëtimet shumëvjeçare në Itali, Greqi, Afrikë, Turqi, si dhe njohja e kulturave antike kanë një ndikim të padiskutueshëm në krijimtarinë e saj. Në letërsinë e saj shihet si përcaktuese përthyerja e emocioneve të botës femërore përmes një ndjeshmërie brilante. Ajo është lirike dhe mjeshtrë e pasqyrit të përvojave personale. Marie Luise Kaschnitz ndërroi jetë në Romë në vitin 1974. Letërsisë gjermane të gjysmës së dytë të shekullit të XX do t'i mungonte një ngjyrë shumë origjinale dhe e pazvendësueshme, nëse i hiqet krijimtaria e Kaschnitz-it.

LIBRI I FUNDIT

Fëmija u kthye vonë sot nga shkolla.

-Ishim në muze,- tha. -Pamë librin e fundit.

Në mënyrë të pavullnetshme hodha sytë nga muri i gjatë i dhomës sonë të ndenjes, i cili dikur mbulohej nga një sërë raftesh plot me libra, ndërsa tani është bosh e i lyster me të bardhë, që të duket televizori i ri plastik. -Edhe, çfarë libri ishte?- thashë e tmerruar.

Thjesht një libër,- tha fëmija. -Me një kopertinë dhe anë të pasme dhe me fletë, të cilat mund t'i shfletosh.

- Po çfarë kishte të shkruar në të?- pyeta.

- Nuk kam nga ta di,- tha fëmija. -Nuk na lejohej ta preknim. Ndodhej poshtë xhamit.

-Sa keq!- thashë. Ndërsa fëmija kishte kërcyer ndërkohë për të ndezur butonin e televizorit. Muri i madh, i bardhë, u gjallërua, tregonte një kope elefantësh që kapërcenin një shtrat lumi në xhungël. Lumi i turbullt llokoçitej, nxitësit indigjenë bërtisnin. Fëmija që rehatuar mbi tapet dhe shikonte me kënaqësi kafshët e mëdha.

"E ç'mund të ketë brenda një libëri të tillë?!"- murmuriste.

Përktheu nga gjermanishtja Marsela Likaj

PARADITE

Dita ka nisë. A do t'i baj ballë apo do të përfundoj tu shkullë flokët?

Duket bukur; dielli që bjen lehtë dhe shpirtrat e tyne janë përkohësisht nëpër shkollë në studim.

Unë jam në qetësi.

Mëngjezi i mirë dhe heshtja – just paradise.

Mandej kam me shku me i marr; edhe bukur, edhe vështirë, por, gjithsesi – jetë!



PASDITE

Tanë kohën rregulloj, sistemoj, i kontrolloj ato që sillen pa teklif, krejt lirshëm.

Rrijnë lakuriq nëpër shpi dhe kanë kërkesa pa fund: me u ba qumështin, me u ble gjana shkollë dhe me ndejt pafundësisht me ta.

Jam shërbëtorja e tyne, kërkoj në këmbim vetëm lumturinë e tyne e asgja tjetër.

U rraskapita...



I BUKUR

- A më don fort?

- Shpirt maj, zemër!

- E ku më ke?

- Itu! - dhe me dy gishta tregon zemrën.

Dikur çohet me shku me fjetë dhe unë e ndaloj.

"Prit! Dogana!" Ai ndalet dhe unë ia nduki faqet, e puthi sa andej-këtej e mandej shkon.

Në darkë shtrihet në divan të guzhinës. Struket si fëmija i rritun që asht. E struki me batanije ma së miri.

Dikur i mban sytë hapë në do mendime e unë i bërtas tu qeshë: "Mbylli sytë!" Shpejt i mbyllë si i xanun në faj dhe flen.

Dikur del prej dushit me flokë të shpupurishun dhe unë i ulem në krah të poltronit. E puthi në flokë dhe ia baj balluket lamsh. Mandej ia studioj dorën: vija e jetës këputet diku, këtë e kam pa me qindra herë.

Përherë asht i tretun në do mendime. "I kena do punë", - thotë dhe sytë i shkojnë larg.

Kos, bukë e thekun shumë dhe djath i bardhë ose mish i pjekun, ushqimet që ma së shumti i lezetohen.

Kajherë merr mbulesën e tavolinës dhe ashtu pesëpalëshe të palosun ven pjtën me kos, bukën e thekun dhe djathin. Jam aty dhe i ngatërrohem nëpër kambë... ia ha bukën, djathin dhe kosin.

"Ti Ner, s'të len me kru dhamin".

Ai më ruen, nuk e di pse, nuk e di ç'ka ka në mue që mendon se mund të më vjedhin, të më zhdukin disi e prandaj merr masa: kudo më shoqnon (te dyqani i disqeve bashkë), kurse me shku në shkollë, më ka caktue shofer.

Ky shqetësim i papushim se diçka mund të na ndodhi, ia nxin jetën; kudo ka rrezik, prej kudo mund të vijë e keqja.

- Ku shkoi, kur erdh', si, kur e pse...

Kur isha fëmi më tregonte përherë një histori, "Konti i Montekristos".

TRUPA NË RANIE

tregime nga Nerinda Hysa

Ishte përherë e njëjta, por mue më tingëllonte përherë ndryshe prej zanit të tij, intensitetit të tregimtarit, mezi pritsha me e dëgju. E dijsa si fillonte: "Ishte një djalë që quhej Edmond D'Antes, që ishte i fejuem me një vajzë, Mercedesin", por s'di pse kisha aq andje me e dëgju. U ndisha e privilegueme.

Plazhi, deti, një vend i adhureshëm. Lezeti i qëndrimit pa ba asgja ose loja pesëkatëshe me të tjerë lojtarë. Lokali i Halimit.

I ruhet diellit të fortë, kujdeset për shëndetin, por asgja s'pin ujë para ngjarjes së madhe dhe ai e din. E ndjen. Asht kurrë mjaft. Asht trand dhe e ka shprehë që po i mbarojnë ditët... por ne asgja s'kuptojmë.

Jena në diell, jena shëndosh e mirë dhe ç'mund të ndodhin...

S'e di, por një fjalë ka mbetë e varun n'ajër. Nuk mujtëm me u përshëndet për herë të fundit, s'munda t'i them "Mirupafshim!" ndërkohë që i kishte sytë të hapun.

Shkoi pa një lamtumirë ose një buzëqeshje.

Sidoqoftë, ajo fjalë ka mbetë atje, e varun në ajrin e atjeshëm dhe e ngrime, e papërdorun.

U nis pa lamtumira, me vedi vetëm zemrën e madhe të ngopun me dashni...

"Mirupafshim!"



NJI MUR

Muri binte pingultas. Ishte nga ata muret e lartë e të plotë. Me një ngjyrë të përdëlyer që të merrte sytë, kurse ashpërsia e relievit të jashtëm e bënte të dukej fortësisht i plotë.

Ai dukej sikur kishte dalë nga asgjëja, ishte si të shikoje një kërpudhë pas shiut.

Asnji nuk e kishte ndërtuar, thjesht ndodhej aty, sikur ndante dy botë, sikur thyente një botë në mes, sikur në këndin e gjelbërimit...

Muri.

Banorët e shushatur që jetonin rrotull, gjithashtu e kishin një mur të tillë në zemër. Një mur i plotë dhe i thiktë ua ndante zemrën në mes,

në mënyrë që ata të mos e shikonin dritën e diellit, thjesht të mos ishin të pranishëm në jetë.

Paragjykime, ndjenja e përgjithshme e shëmtisë, servilizmi dhe frika ndaj më të fortit, ashpërsia në gjuhën e folur dhe shëmtia e përgjithshme e sjelljes, këtë kishte shkaktuar Muri te njerëzit e zonës.

Përgjithësisht të trashë dhe të dendur me gënjeshtër, ata shkonin në një rrugë të keqe, që e quanin "jeta jonë". Ata nuk ngjanin me njerëzinë e butë që jeton në anën tjetër të botës.

Epo ata jetonin kështu me shekuj, e kur më në fund u zgjuan në një ditë të etshme janari, Muri kishte mbërritur deri në qiell dhe e cikle atë.


Njerëzit nuk shikonin gjë tjetër përveçse Mur të lartë, të kuq dhe të fortë, të trashë me kilometra.



TRUPA NË RANIE

Gjithçka po mbaron lehtë, lehtë si shiu.

Sa kohë kemi para se të plakemi, para se trupi



ynë të rrëshqasë lodhshëm.

Epo ajo është afër të shtatëdhjetave; e kam parasysh këtë fakt...

I shikon prindërit të plaken, mandej të vdesin dhe nuk e din cila asht ma e tmerrshmja.

Plasja, thyerja dhe flashkja e lëkurës, rrëzimi i qimeve. Mandej mundimet me ndalu kohën; heqje rrudhash, lyerje flokësh dhe gjëra që kullojnë.

A do të vazhdoj me e dashtë trupin edhe kur të jetë i plakun, i cflitun?

Po edhe sa vjet do të duhen...

Mendja punon furishëm, mendja punon. Zhbiriluese. E shkëputun prej trupit, biles pa kurrfarë lidhjet me të.



BOSHE

Fëmi që ju lëshova n'ërë, ju hodha, ju treta.

Barra të thyeme. Nuk do t'ju njoh kurrë. Në askurrë.

Më keni lan një birë n'zemër, një boshllëk të madh, një gropë ku do të futem. Kam dëshirë me u kthye aty ku ishit dhe me jua tok dorën 'Toke këtu'.

I shoh fmit që i kam rrotull, që janë me mue dhe mendoj për boshllëkun që e latë ju. Një shëmtin, një gja si brengë. Kjo asht diçka që s'duhet ba. Kurrsesi.

Me i nisë fmit nëpër erna të ftohta e me i la duert me to, tu pi çaj n'minder. Mandej një sëmundje të kaplon e të përmyt dhe ti që dojshe me shiju jetën, pa fmi.

S'mund të them 'mirupafshim', s'mund të them 'do t'shifna'.

Por veç kjo birë n'zemër, kjo dhomë e madhe boshe pa za, pa jetë, veç një e qame e hedhun diku.

Barrë e thyeme.

Disa gra mbulojnë fytyrën me duer dhe vazhdojnë para, nuk flasin kurrë për fmit e lëshuem nëpër erna, nuk i tregojnë askujt, madje as mureve, mirëpo kur i shikon në sy e kupton që duert e fmive të palindun jua mbulojnë sytë si n'lojë (tu u tallë disi me to, me nanat e tyne që s'i mbajtën).

A po e shijoni jetën tash që i hodhët fmit tuj ndër plehna, tash që pshtut prej tyne. A po gëzoheni tu vesh fustane elegante, a po mërztiteni, ndopak... thjesht 'ndo pak'.



AI

Për besë po. Në tanë atë gunë të vjetër dalloheshin dy palë sy. Të vecërr. Mandej diçka tjetër, e padallueshme. Nuk u mor vesh nga shkoi, por nata i ra si një jorgan i butë dhe i stolisun me një shikim.

Pas shumë vitesh e kam pa. Tjetër njeri dukej. Tash rrinte i qetë para meje.

Fytyra shndriste dhe pamja jashtë ishte po ajo; Natë. Por, ai rrinte drejt, biles tallej me te. Në shtroje të shtroje të tokës e zu gjumi ...

Mandej e pashë tek ikte për diku. Tretej me atë bukuri në shpatulla.

I dhashë lamtumirën me një puthje.



“Kalabria është një kopësht i madh, një nga vendet më të bukura që mund të gjesh mbi tokë”, shkruante më 1847 piktori e shkrimtari anglez, Edward Lear, i cili udhëtoi për 40 ditë rreth e qark tokës kalabreze, duke ndjekur rrugëtimin antik romak Egnatia, që e solli më pas deri në Shqipëri

Kalabria ky “kopësht ekzotik”!

nga Alba Kepi

“Kalabria është një kopësht i madh, një nga vendet më të bukura që mund të gjesh mbi tokë”, shkruante më 1847 piktori e shkrimtari anglez, Edward Lear, i cili udhëtoi për 40 ditë rreth e qark tokës kalabreze, duke ndjekur rrugëtimin antik romak Egnatia, që e solli më pas deri në Shqipëri.

Pak vite më vonë thuhet, (dhe pse nuk ekziston një dokument letrar i shkruar, por kalabrezëve i pëlqen aq shumë sa nuk e vejnë më në dyshim), se simboli i dekadentizmit evropian Gabriele D’Annunzio do ta përshkruante si “kilometrin më të bukur italian”, një vijë bregdetare rreth 800 km që harkon majën e “çizmes” së Gadishillut Apenin.

Sot dhe pse nuk është më e njëjtë si në kohën e udhëtimit këmbësor të Lear, Kalabria vazhdon të jetë po kaq e “ekzotike” siç e përshkruante ai, e kalabrezët ruajnë ende shpirtin e pandotur nga veset qytetare borgjeze me krenarinë e të qenit “meridonal” (jugor) si dikur kur intervistoheshin nga “intelektuali skandaloz” i ‘900 italiane, Pier Paolo Pasolini.

“Në Kalabri, do shkruante Pasolini, është kryer krimi më i rëndë, për të cilin nuk do mban përgjegjësi askush. Është vrarë shpresa puro (e pastër) pak anarkike e feminare e atyre që jetuan para historisë e kanë ende përpara tërë historinë.”

E Pasolini kishte të drejtë sepse ky territor që sot quhet Kalabri 15 shekuj para lindjes së Krishtit quhej Italia, e banohej nga fisi antike Itali. E këtë fakt historik kalabrezët nuk e harrojnë e kur biseda është shtruar e ngacmimi intelektual prek sedrën e tyre, ata përgjigjen “jemi kalabrezë para se të jemi italianë”.

Kur mbërrin në Kalabri si nga toka apo nga deti mendon se natyra ka qënë kaq zemërgjerë me të. Male e lugina me bimësi mesdhetare të larmishme e të rralla sa janë qytezat e banorët që e popullojnë, deti Jon e deti Tirren formojnë gjire, golfe e plazhe të fshehura që banorët i konservojnë me xhelozë nga turizmi i masës e dëshmi të një multikulturalizmi të imponuar nga historia por që kalabrezët e kanë vlerësuar në pasuri sociale të popullsisë së tyre të hershme e të sotme.

Qifti shqiptar në zemër të Parkut më të madh natyror

Në këtë perimetër tokësor, unik, ku fliten 4 gjuhë zyrtare (italishtja, arbërishtja, gjuha greke e oçitane) e dhjetra dialekte që ndryshojnë zanoret nga një provincë në tjetrën, gjëndet një nga magjitë natyrore të jugut të Europës. Është Parku i Pollinos, parku më i madh natyror në Itali, parku më

i shtrirë (i gjerë) i Europës e pasuri e Uneskos. Në zemër të tij jetojnë rreth 1000 banorë që Kalabrinë e quajnë Kalavri e për veten thonë “jemi arbëreshë nga Shqipëria e kalabrezë prej motë’c”.

Janë banorët e qytezës Qifti apo Civita në gjuhën italiane. Mes pllajave të larta deri në 2200 metra, qyteza arbëreshe shfaqet si një relike mesjetare urbane, të cilën vendlinjë e zonës e thërrasin “qyteza mes shkëmbijve.”

Kanë kaluar mbi 5 shekuj që ata ndodhen mes shkëmbesh, në një tokë që e duan po aq sa dhe Arbëria e tyre.

Sa më shumë i afroshesh këtij parku aq më gjigand e shkëmbor duket Mali i Pollinos prej të cilit ka marrë dhe emrin. Pishat antike mbi 1200 vjecare krijojnë guidën e parë natyrore drejt “qytezës mes shkëmbinjve”- Mbi 400 metra mbi detin, Civita shqiptar ka një relief natyror magjeps, i rrethuar nga kanionet e lumit Raganello, nga bimësia e pllajës së Pollinos e mban kurorë mbi krye Malin Raza (Rrëza).

Civita është një nga 50 komunat arbëreshe që janë të pozicionuara në 5 rajone të ndryshme italiane. Arbëreshët, katundin e tyre e thërrasin Qifti, fjalë që mban kuptimin “vetë i dytë” në shqip, por me versione të ndryshme të historisë së emrit.

Shumë e lidhin me dy lagjeve kryesore të saj; San’Antonio e Magazeno, të tjerë me morfologjinë e fjalës qifti-shqiptonja, apo me fjalën latine civitas-qytete. Të tjerë interpretojnë vendodhjen gjeografike

me historikun e banorëve, e që ky emër mund të kujtoj follenë e shqiptonjave. I fshehur mes shkëmbinjve e mjaft pranë kanioneve ishte vendi ideal për t’i shpëtuar barbarisë së ushtrisë turke, që pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, detyroi mijëra arbëreshë të braktisin atdheun e tyre.

Vizita në qytezën arbëreshe është surpriza e parë që të rezervon ky krah i Kalabrisë. Emrat e rrugëve, shkollat, ndërtesave publike, janë në dy gjuhë; shqipe e italiane. Në mes të katundit, në sheshin “Skëndërbe”, ndodhet Bashkia në ballkonin e së cilës valëviten flamuri italian dhe ai evropian. Është një ndërtesë e rëndësishme trekatëshe që dallon nga ndërtesat e tjera, e përballë së cilës ndodhet Kroji i katundit. Nuk ka qytezë arbëreshe pa kroin e vet, vendi i preferuar i gjitonisë.

Në krahun e djathtë të Bashkisë, mbi një pedestal gurash e në një vend strategjik që sheh nga Mali i Pollinos, ndodhet busti i Skëndërbeut. Është orar dreke e një grup fëmijësh janë ulur buzë monumentit e bisedojnë vesh më vesh sikur t’i ruhen qetësisë së tij. Jeta rjedh shtruar në rrugicat e katundit, të ngushta e gjarpërushe me sytë kureshtarë e të rezervuar të banorëve. Rugicë pas rrugice shpreson të gjesh në ato sy qiftjotin e moshuar, fotografia e të cilit kokëulur e në këmbë, ndësa priste të shiste arkat me kajsitë e mbledhura në kopështin e tij, mori me mijëra klikime në internet e meritoj faqen e parë të një prej gazetave më të rëndësishme kombëtare.





Një nga "bizhuteritë" historike të katundit Qifti: Muzeu Etnik Arbëreshë.

Muzeu Etnik nuk ka dry e as celësa. Ai ruhet nga të gjithë me portën hapur në çdo orë të ditës. Që në prag dëgjohet muzika e këngëve arbëreshe që mbushin të dy katet e tij. Gjen aty kostumet arbëreshe burrash e grash të periudhave të ndryshme kohore, harta të vjetra të Arbërisë antike, objekte të zakoneve të jetës së përditshme arbëreshe, libra të vjetër, fotografi e dokumente historike të banorëve të parë të kësaj qyteze se Qifti mori jetë më vitin 1471 e nisi të popullohet me banorët e parë në harkun kohor të viteve 1470-1490.

Profesor Vincenzo Bruno është një historian i respektuar i zonës, është dhe kujdestari i këtij Muzeu. "Nuk jam drejtor thotë, cdo gjë e bëjmë me punë vullnetare e për këtë muze kemi punuar të gjithë çiftjtë. Ai thotë se ka rreth 30 vite që u ndërtua bërthama e parë e këtij muzeu. "Është një vandecum për komunitetin tonë arbëreshë, shprehet ai, janë prova të jetës tonë të përditshme, elementë të ekzistencës arbëreshe në këtë territor, "Ky muze, shton, u krijua me një financim të Komunitetit Europian, por më pas e deri më sot pasurohet, ruhet e kujdeset nga kontributi vullnetar i banorëve të Qiftit.

Një nga evente kulturore më tipike e të rëndësishme për këtë qytezë arbëreshe është Festa e Valles. Ajo festohet cdo vit në ta martën e parë pas Pashkëve dhe evokuar fitoren e heroit tonë kombëtar Skënderbe kundër Turqve për çlirimin e Krujës më 24 prill 1467. Sipas kalendarit të kohës kjo ditë përkonte me të martën e parë pas Pashkëve. "Në festën e Valles, thotë Profesor Bruno, vashat e gratë e Qiftit veshin të kostumet tradicionale arbëreshe që ruhen në cdo

shtëpi. Këndojnë, vallëzojnë, gjarpërojnë nëpër rrugë, e imitojnë kapjen e robërve sic bëri Skënderbeu me turqit në betejën e Krujës. Këndojnë këngët tona arbëreshe si Kënga e Skënderbeut, Kënga e Doruntinës, etj."

Prej qershorit të vitit 2019 Muzeu etnik arbëreshë është etiketuar si Muzeu me interes strategjik rajonal, fakt që e bën të jetë pjesë e rrjetit institucional të muzeve në të gjithë rajonin e Kalabrisë, e që favorizon aktivitetin e tij. Njëherësh është një vlerësim për cilësinë e tij, akseset e standartet e sigurisë të përcaktuara në nivel kombëtar.

Dhe pse në Civita si pothuajse në të gjitha komunat arbëreshe flitet gjuha shqipe, mungesa e mësimit të saj korrekt nëpër shkollë preokupon banorët. Profesor Vincenzo Bruno thotë se "aktualisht mësimi i gjuhës shqipe nuk është i detyrueshëm nëpër shkollë. Por mund të realizohen projekte një vjeçare për mësimin e saj dhe në orët e lira pasdite, pas shkollë."

"Shtëpitë folëse!-Shtëpitë "Kodra"

Një karaktersitikë unike e arkitekturës urbanistike të qytezës arbëreshë janë "shtëpitë folëse", banesa të vogla pjesa ballore e të cilëve me dritaret, portën e oxhakun krijon idenë e pamjes së fytyrës së njeriut. Njihen ndryshe dhe si "shtëpitë Kodra" për shkak të ngjashmërisë së tyre primitive me stilin artistik të piktorit të madh shqiptar Ibrahim Kodra. Porta qëndrore kujton buzët, dy mini dritaret në katin e dytë ngjajnë me sytë e oxhaku që shfaqet në relievin e fasadës është hunda që merr formë e madhësi të ndryshme.

Qyteza arbëreshe Qifti ka hyrë në listën e fshatrave

më të bukura italiane si dhe është vlerësuar me Flamurin e Verdhë, për cilësinë turistike e ambientale, cmim ky i përcaktuar nga Shoqata kombëtare Touring Club Italia, e cila promovon turizmin në tërë territorin italian.

"Udha e Bulervet", ("Via dei Nobili" në gjuhën italiane) të drejton në pllajën e Pollinos, një spektakël natyror që të lë pa frymë. Një grup turistësh gjermanë shoqërohen nga Mikele giuda e zonës- "Kjo qytezë arbëreshe, thotë ai, ndodhet në portën hyrëse të Parkut të Pollinos. Nga këtu pasi kalon kanionet e lumit Rganello e pllajën e Polinos, mbërrin në majat më të larta të Italisë Jugore sic është Maja "Dolcedorme" e lartë 2267 metra. Qifti arbëreshë, thotë ai, është pozicionuar në territorin më të madh natyror, pasuri e UNESCO-s. E jo vetëm kaq, në rreth 200 mijë hektarë tokë që mbulon Parku i Pollinos, ndodhen gjithsej 8 komuna arbëreshe.

"Codex Purpureus Rossanensis" / Memory of the world

Vetëm pak kilometra larg Qiftit arbëreshë, Kalabria të servis një dëshmi unike të historisë së saj. Në Komunën e Rossano-s është zbuluar Ungjilli më antik në botë, i klasifikuar në kategorinë "Memory of the World" pasuri e Uneskos.

"Codex Purpureus Rossanensis", Kodi i purpurtë, ruhet në Muzeun Dioqezan i Arit të Shenjtë të qytetit e është një dorëshkrim biblik në gjuhën greke që përmban Ungjillin sipas Matteos e Markut e një letër të peshkopit e shkrimtarit antik grek Eusebio. Kodiku i i Rossano-s quhet i Purpurtë për shkak të fletëve ngjyrë të purpurtë që ai ka, ku shfaqen një seri figurash në miniaturë që ilustrojnë jetën e predikimit e Jezusit të shoqëruara me tekste të shkruara në ar e argjendë.

Kodiku i purpurt u gjet nga teologu gjerman Adolv Von Harnack më 1879 në katedralen e Shën Mërisë së Shenjtë të Rossano-s. Konsiderohet një nga dorëshkrimet më antike të Testamentit të Ri të Biblës së Krishterë i shkruar në shekullin V-VI të e.s

Ari jeshil i Kalabrisë

Nuk mund të thuash se ke vizituar "kopshtin ekzotik" te Lear pa shijuar, pijen cedrata, analkolike, freskuese me aromën natyrale të frutit të qitros.

Një rivierë qindra hektarësh me pemë qitro rrethojnë Kalabrinë, favorizuar nga klima e terreni. E quajnë "ari jeshil i Kalabrisë" e ka konsorciumin e saj zyrtar në qytezën Shën Maria e Qitros (Santa Maria del Cedro. Me një prodhim prej mijëra kunital në vit, ky fryt është një nga produktet me një eksport të konsiderueshëm në territor, e që përdoret mjaft në industrinë farmaceutike, kozmetike, në pasticieri, kuzhinë, por dhe në kultin fetar të hebrenjve, të cilët e konsiderojnë frutin më të bukur mbi tokë.

Inagurohet Biblioteka "Zoja e Shkodrës"

Sikur historia na tregon, në Shqipëri kultura e të shkruarit zë fill me meshtarët katolikë, fillimisht me atë që jetonin, studionin dhe shërbenin jashtë (nga Buzuku, deri te Barleti) e pastaj, me të tjerët që brenda Atdheut ditën të shërbenin në të mirë të Tij dhe të Zotit. Mes tyre, i pari që duhet përmendur është Atë Fishta, por nuk duhen lënë në harresë të tjerë si dom Ndoc Nikaj, autori i të parit roman shqiptar.

Pikërisht në famullinë ku i pari romancier

shërbeu, ditën e hënë me datë 21 tetor, kur Kisha përkujton "Zojën e Shkodrës" u inaguroi një bibliotekë me emrin e Saj e cila do të jetë në dobi të qytetit, si një ambient i ri që i shërben kulturës.

Për të krishterët, biblioteka ka një kuptim sa kulturor, aq edhe shpirtëror pasi vetë Krishti është Fjala që mishërohet në humanizmin tonë. *Prandaj qëllimi i kësaj Biblioteke është të aftësojë dhe ta lartësojë njëriun në Fjalën.*

A.D



Fjalori i Kostandin Kristoforidhit dhe diplomacia greke

Hasan BELLO



Kostandin Kristoforidhi (1827-1895) ka qenë studiues i shquar i gjuhës shqipe dhe veprimtar i Rilindjes Kombëtare. Ai lindi në Elbasan në vitin 1827 dhe nga viti 1847 studioi në gjimnazin Zosimea të Janinës. Gjatë kësaj kohe ai ndihmoi albanologun e njohur J.G.Han për të studiuar shqipen e për të hartuar një fjalor shqip-gjermanisht. Në vitin 1857 ai shkoi në Stamboll dhe më pas në Maltë ku qëndroi deri më 1860 në një seminar protestant, ku përfundoi përkthimin e “Dhjatës së re” toskërisht e gegërisht. Në këtë periudhë ai paraqiti disa ide për autonominë e Shqipërisë, për lashtësinë e virtytet e shqiptarëve, si dhe gjendjen e arsimit e të dialekteve të shqipes në punimin “Shënime mbi Shqipërinë, gjuha dhe përkthimi i shkrimeve të shenjta” (1860). Për disa vite ai ushtroi profesionin e mësuesit në Tunis, ku hyri në marrëdhënie me përfaqësuesin e Shoqërisë Biblike të Londrës në Stamboll. Në vitin 1866 ai përfundoi përkthimin e parë gegërisht “Katër Ungjijtë dhe punët e Apostujve” dhe vijoi për shumë vjet përkthimet “Psallmet” (1868 toskërisht, 1869 gegërisht), “Dhjata e re” (gegërisht 1869, toskërisht 1879), “Të bërët dhe të dalët” (toskërisht 1880), “Nomi i dytë” (toskërisht 1882) “Fjalët e urta të Solomonit” dhe “Vivla e Isaisë” (toskërisht 1884). Ai ka lënë dorëshkrim “Krijesa dhe të dalët” gegërisht, si edhe disa shkrime të tjera që nuk janë gjetur. Kristoforidhi udhëtoi disa herë nëpër Shqipëri që nga viti 1870 për të mbledhur fjalë e shprehje nga goja e popullit, për të përhapur librat e vet dhe për t’u mësuar bashkatdhetarëve shqipen letrare. Në vitin 1884 ai u vendos në Elbasan, ku vijoi të mësonte shqipen fshehurazi derisa vdiq.

Vepra themelore e Kostandin Kristoforidhit, për të cilën punoi gjithë jetën, është “Fjalori i gjuhës shqipe”. Fati i këtij fjalori ishte një kalvar i gjatë dhe plot mundime. Për gjetjen dhe botimin e tij u përfshinë disa shtete (Greqia dhe Austro-Hungaria) dhe diplomatë.

Më 29 tetor 1897, konsulli austro-hungarez në Shkodër Teodor Ippen i raportoi ministrit të Jashtëm kont Goluhovski se nacionalistët shqiptarë të Elbasanit e kishin vënë në dijeni se gjuhëtari i njohur Kostandin Kristoforidhi kishte hartuar një fjalor shqip-greqisht në dorëshkrim dhe se botimi i kësaj vepre popullore do ta nxiste jashtzakonisht rilindjen gjuhësore në të gjithë Shqipërinë. Meqenëse patriotët shqiptarë prisnin nga Austro-Hungaria përkrahjen e aspiratave kombëtare, ata i luteshin Vjenës të merrte përsipër botimin e kësaj vepre. Ippen kishte kërkuar nga këta të fundit, që trashëgimtarët e Kostandin Kristoforidhit, i cili kishte ndërruar jetë dy vjet më parë, t’i tregonin dorëshkrimin origjinal. Nga ky konstatim, ai kishte arritur në konkluzionin se fjalori nuk përmbante 40.000 fjalë, siç pretendonin patriotët shqiptarë, megjithëse ai ishte një punim me shumë vlerë.

Për botimin e këtij fjalori, trashëgimtarët e Kostandin Kristoforidhit i kishin deklaruar Ippen-it se ata kishin pasur disa oferta: një ofertë nga Shoqëria Biblike Amerikane prej 700 fundesh (njësi monetare); një ofertë nga partia kombëtare në Korçë prej 300 fundesh; dhe një ofertë nga dijetari gjerman

Weigandi, docent në universitetin e Laipzigit, i cili kishte vizituar Elbasanin rreth vitit 1889 dhe kishte ofruar një shumë prej 400 fundesh turke.

Ippen në raportin drejtuar ministrit të Jashtëm shprehte shumë rezerva mbi këto oferta, duke i quajtur ato shuma përrallore, të cilat nuk duheshin marrë aspak në konsideratë. Ai i kishte deklaruar patriotëve shqiptarë të Elbasanit se personalisht ishte i mendimit se qeveria osmane, nuk kishte asnjë interes për një ndërrmarje të tillë dhe se në rastin më të mirë për botimin e këtij fjalori mund të kishte interes Akademia e Shkencave në Vjenë. Por, edhe për këtë Akademi kjo nismë ishte një ndërrmarje e kushtueshme, pasi dorëshkrimi nuk ishte gati për t’u shtypur dhe se albanologët e njohur si profesor Mayer në Grac dhe profesor Jarnik në Pragë ishin të mendimit se për këtë nevojitej një punë 1-2 vjeçare. Sipas Ippen-it, duke marrë parasysh rrethanat ekzistuese, as që mund të bëhej fjalë që ky dorëshkrim t’u blihej trashëgimtarëve të Kristoforidhit nga ana e Austro-Hungarisë. Ai ishte i mendimit se kjo ishte detyrë e patriotëve shqiptarë, ndërsa lidhur me botimin e veprës atyre nuk do t’u mungonte përkrahja e Vjenës. Megjithatë, Ippen shprehej skeptik lidhur me faktin se patriotët elbasanas do ta ndiqnin deri në fund këtë çështje. Ai besonte se edhe ata, ashtu si të gjithë shqiptarët, vuanin për mungesë qëndrueshmërie dhe, se çështja e fjalorit të Kristoforidhit ende për shumë kohë do të mbetej pezull.

Por, një interes për fjalorin e Kristoforidhit, ndonëse ishte tepër vonë, Vjena do të tregoi në fillim të shek.XX. Kështu, më 30 korrik 1901, nënkonsulli austro-hungarez në Manastir, Kral i raportoi ministrit të Jashtëm se me rastin e vizitës së markezit Carlotti në Elbasan, ky i fundit kishte zhvilluar një vizitë tek i biri i Kristoforidhit. Pyetjes së markezit Carlotti lidhur me fjalorin e të atit, i biri i Kristoforidhit i ishte përgjigjur se atë, e kishte dërguar në Athinë. Kjo ngjalli shqetësim të madh në Vjenë, pasi autoritetet austro-hungareze



kishin arritur në përfundimin se botimi i fjalorit mund të sillte një përfitim të rëndësishëm për çështjen kombëtare shqiptare. Por, mbi të gjitha shtypja e këtij fjalori përbente një interes dhe sukses moral mjaft të madh për autoritetet austro-hungareze. Prandaj, nënkonsulli austro-hungarez në Manastir, u udhëzua me detyrën për të zhvilluar hetime të mëtejshme mbi vendndodhjen e dorëshkrimit. Për këtë, ai ngarkoi një person të besueshëm, i cili pas shumë përpjekjeve mbledhi informata sipas të cilave, patrioti Visar Dodani kishte deklaruar se Shoqëria “Dituria” në Bukuresht kishte vendosur të dhuronte mijëra franga për blerjen dhe botimin e fjalorit. Prandaj, i biri i Kristoforidhit ia kishte dorëzuar fjalorin konsullit grek të Manastirit, që ky ta dërgonte në Bukuresht. Por konsulli grek, siç duket me urdhër të eprorëve, në vend që ta dërgonte në Bukuresht, e kishte dërguar në Athinë. Ndërsa patrioti tjetër i kolonisë shqiptare të Bukureshtit, Nikolla Naço, kishte deklaruar se elementët ortodoksë shqiptar të kësaj kolonie, të cilët njiheshin për prirjet e tyre filogreke dhe filloslave, kishin qenë pengesë kryesore për botimin e fjalorit. Sipas tij, kishin qenë pikërisht këta që kishin nxitur konsullin grek të Manastirit për ta shtënë në dorë dhe për ta zhdukur fjalorin e Kristoforidhit. Ndërsa versioni i tretë dhe më i besueshëm lidhur me destinacionin e fjalorit ishte se Shoqëria “Dituria” i kishte propozuar të birit të Kristoforidhit një shumë prej 3000 frangash. Por ky i fundit u kishte kërkuar dyfishin. Gjatë këtyre tratativave, konsulli grek i Manastirit i kishte propozuar 6000 franga, por nga frika se mos ia zhduknin veprën e të atit fillimisht ai kishte refuzuar, ndërsa më vonë për shkak të nevojave materiale kishte pranuar. Pavarësisht këtyre versioneve, ministria e Jashtëm në Vjenë e udhëzoi nënkonsullin austro-hungarez në Manastir, që të zhvillonte hetime dhe të bënte çmos për ta gjetur këtë fjalor.

Një vlerësim të jashtzakonshëm për fjalorin e Kristoforidhit bënte edhe Faik Konica. Ai i shkruante ministrit të Jashtëm kont Goluhovski se, duke u mbështetur në të dhënat e August Dozon-it që në vitin 1876, ky fjalor duhet të kishte së paku 40.000 fjalë dhe një sasi prej 2000 faqesh. Faik Konica i sugjeronte autoriteteve austro-hungareze që të hynin në bisedime me të birin e Kristoforidhit, të cilit, për të konfirmuar vendndodhjen e fjalorit, duhet t’i deklaronte se për botimin e tij kundrejt një shpërblimi të majmë ishte e interesuar një shoqëri filologjike vjeneze. Kjo, sipas Konicës, do ta bënte atë të besonte lehtë në seriozitetin e bisedës. Ai arsyetonte se në mendësinë e shqiptarëve të paditur apo gjysmë të mësuar, e gjithë bota e admironte gjuhën tonë dhe dijetarët e të gjitha vendeve e kalonin jetën e tyre mbi tekstet e gjuhës shqipe.

Autoritetet austro-hungareze u treguan të gatshme për ta gjetur fjalorin e Kristoforidhit me çdo kusht. Në një raport drejtuar nënkonsuljeve në Durrës dhe në Manastir, si dhe konsullit austro-hungarez në Shkodër, Ministria e Jashtëm në Vjenë i autorizoi ata që të hynin në tratativa me pronarin pa rënë në sy dhe ta blinin atë me çmimin e ofruar prej tij. MPJ i sugjeroi gjithashtu që të bënin kujdes lidhur me autenticitetin e veprës.

Për të shmangur çdo mashtrim të mundshëm, Vjena i udhëzoi diplomatët në fjalë që të konsultoheshin me të dhënat e August Dozonit dhe veçanërisht me konsullin austro-hungarez të Shkodrës, Ippen-in, i cili kishte pasur rastin për ta parë i pari fjalorin e Kristoforidhit. Në kuadër të kësaj nisme, nënkonsulli austro-hungarez në Durrës, Kwiatkowski, i raportoi Vjenës se kishte zhvilluar një bisedë me djalin e Kristoforidhit, i cili i kishte deklaruar se dorëshkrimin e fjalorit ia kishte dorëzuar para një viti një personi të besueshëm të konsullatës greke, kundrejt një premtimi se kjo e fundit do t'i jepte 200 napolona ar dhe 100 copë të veprës së shtypur. Fjalori, sipas të gjitha gjasave, tani ndodhej në Ministrinë e Jashtme të Greqisë. Madje, ministri i Jashtëm i kishte propozuar një shpërblim 150 napolona ar e pastaj 170 dhe, në vend të 100 ekzemplarëve, një shumë të arsyeshme. Por, i biri i Kristoforidhit, duke parë politikën greke, e kishte refuzuar këtë propozim. Ai kishte krijuar bindjen se Athina, me blerjen e kësaj vepre, nuk synonte botimin e saj. Përkundrazi, ajo kishte si qëllim që ta pengonte atë, pasi shtypja e fjalorit binte në kundërshtim me qëllimet helenizuese ndaj popullit shqiptar. Por, fatkeqësisht, i biri i Kristoforidhit, kur kishte dorëzuar fjalorin nuk kishte marrë asnjë dokument ku pala greke të zotohej zyrtarisht, që nëse vepra nuk botohej brenda vitit, ajo duhej t'i kthehej pronarit të saj. Patriotët elbasanas, sipas deklaratave të djalit të Kristoforidhit ishin acaruar jashtëm nga ky qëndrim i Ministrisë së Jashtme greke dhe kishin arritur deri aty sa kishin kërcënuar se nëse nuk u kthehej fjalori, ata do të digjnin shkollat greke të Shpatit. Ai i kishte deklaruar gjithashtu nënkonsullit austro-hungarez në Durrës se, brenda 14 ditëve do t'i kërkonte konsullatës greke kthimin e një përgjigjeje definitive, ose në rast të kundërt kthimin e dorëshkrimit. Në rast se ndodhte kjo e fundit, ai i kishte propozuar nënkonsullit austro-hungarez që ta blinte atë me të njëjtën ofertë, kundrejt 200 napolona ar dhe 100 copë ekzemplar. Sipas të dhënave të diplomatit austro-hungarez, përpjekje për ta shtënë në dorë fjalorin e Kristoforidhit ishte duke bërë edhe nënkonsulli italian në Durrës, Macchiora.

Deklaratat e mësipërme të Stefan Kristoforidhit u konfirmuan edhe nga ambasadori austro-hungarez në Athinë, baron Burian. Ai i raportoi Ministrisë së Jashtme në Vjenë se në bazë të informatave që kishte grumbulluar, autoritetet greke, çmimin e ofruar prej tij e konsideronin mjaft të lartë në raport me të metat që kishte fjalori.

Sipas nënkonsullit austro-hungarez në Manastir, Kral, duke u mbështetur në informatat e mbledhura nga i ngarkuari i tij për zgjidhjen e këtij problemi Gjergj Qiriaz, Stefan Kristoforidhi tani gjendej nën presionin e patriotëve elbasanas. Ata e kërcënonin atë se i shtyrë nga borxhet që i detyrohej Veniamin Nosit ishte mashtruar nga ky i fundit, i cili këtë fjalor ia kishte dorëzuar konsullit grek.

Në bazë të udhëzimeve që mori nga Vjena, nënkonsulli austro-hungarez në Durrës i deklaroi Stefan Kristoforidhit se ishte i gatshëm të binte dakord me konditat e vendosura prej tij, duke e blerë fjalorin kundrejt 200 napolona ar dhe 100 copë ekzemplar. Për këtë qëllim, ai kishte zhvilluar një vizitë në konsullatën greke, ku kishte kërkuar rikthimin e fjalorit. Nënkonsulli grek, fillimisht ishte përpjekur që t'ia mbushte mendjen se çmimi që ai kërkonte ishte shumë lartë dhe i kishte ofruar shumën 175 napolona ar. Por, kur kishte parë se Stefan Kristoforidhi kishte refuzuar çdo lloj shume, i kishte deklaruar se për Ministrinë e Jashtme greke, blerja e fjalorit tani konsiderohej një çështje e përfunduar dhe kurrësi nuk mund ta rikthente. Madje, sipas nënkonsullit grek, Ministria e Jashtme shumë e premtuar do ta depozitonte në një bank, në llogari të Stefan Kristoforidhit.

Kalvari i fjalorit ndoqi edhe fatin e Stefanit. Gjatë kthimit për në Elbasan ai u arrestua së bashku me shoqëruesin e tij Mhill Zefin prej Mirdite nga xhandarmëria osmane, e cila gjatë kontrollit u gjeti



atyre një numër të konsiderueshëm letrash dhe gazetash në gjuhën shqipe. Një rol të veçantë për këtë luajti edhe nënkonsullata greke. Ajo ishte e interesuar që Stefan Kristoforidhi të haste sa më shumë pengesa, me qëllim që të mos gjente kohë për të rendur pas fjalorit. Në Elbasan, arrestimi i tyre bëri jehonë të madhe. Sipas nënkonsullit austro-hungarez në Manastir, Kral-it, nëse më përpara "Albania" dhe "Drita" lexoheshin pa frikë në mes të rrugës dhe kishe mundësi të blije libra shqip në të gjitha dyqanet, tani të gjithëve u kishte hyrë frika. Patriotët elbasanas me në krye Dervish beun, Shefqet beun dhe papa Germanosin i ishin lutur Kral-it që të bënte çmos për lirim të tyre, sidomos të Stefanit nga i cili varej edhe fati i mëtejshëm i fjalorit. Por, kjo ishte jashtë mundësive të tij, për shkak se ngjarja nuk ishte brenda kufijve të zonës që ai mbulonte. Gjithësesi, Kral i lutej ministrit të Jashtëm të kërkonte

nga konsulli austro-hungarez në Shkodër të ushtronte influencën e tij lidhur me lirim të Stefanit, qoftë edhe duke kompromentuar provat me ryshfet.

Bashkë me Stefanin dhe shoqëruesin mirditor u arrestua edhe patrioti Lef Nosi, i cili në kundërshtim me vëllezërit e tij ishte skeduar nga diplomacia greke si nationalist shqiptar. Ata u dërguan në burgun e Selanikut ku qëndruan për disa muaj. Ndërkoh që si rezultat i trysnisë së diplomatëve të huaj që ishin në kërkim të fjalorit, kërcënimeve të patriotëve shqiptar të Elbasanit, sidomos të Dervish bej Biçakut, autoritetet greke pasi krijuan një komision ekspertësh për vlerësimin e fjalorit e botuan atë në vitin 1904. Botimi i këtij fjalori pati jehonë të madhe, megjithëse ai u shtyp me germa greke.

Ribotimi i tij në gjuhën dhe alfabetin shqip u bë i mundur pas 70 vjetësh.

JOAN DIDION

Blloku im i shënimeve

“Ajo grua, Estelle,” lexoj shënimin, “është deri diku Arsyeja pse George Sharp dhe unë u ndamë sot.” Letër ambalazhi e një krepit të pisët kinez, bari i hotelit, Rruga Wilmington, 9:45 para dite, mëngjezi i një të hëne gushti.” Meqenëse ky shënim ndodhet në bllokun e shënimeve, duhet të ketë doemos njëfarë kuptimi për mua. E studioj për një kohë bukur të gjatë. Në krye të herës kam vetëm njëfarë ideje shumë të largët të asaj që po bëja atë mëngjez të hëne gushti në barin e hotelit në anën e kundërt të stacionit hekurudhor të Pennsylvania-s në Wilmington, Delaware (po prisja trenin? Sapo e kisha humbur? Ishte viti 1960? 1961? Pse Wilmington-i?). Sidoqoftë më kujtohet që kam qenë në atë vend. Gruaja që mbante letrën e ambalazhit të një krepit të pisët kinez kishte zbritur nga kati i sipërm ku kishte dhomën për të pirë një birrë dhe kamerieri kish dëgjuar pak më parë arsyen pse George Sharp-i dhe ajo qenë ndarë atë ditë. “Sigurisht,” tha ai, dhe vazhdoi të pastronte me leckë dyshteme. “Vetë më treguat.” Në cepin tjetër të barit është një vajzë. Ajo po flet, dhe duket që nuk po fet me burrin ngjitur, por me macen e shtritur në trekëndëshin e dritës që depërton përmes hapësirës që krijon dera e hapur. Ajo ka të veshur një fustan të mëndafshë nga ato të dyqaneve të veshjes “Peck & Peck”, me kinda të lëshuara poshtë.

Ja si është puna: Vajza ka jetuar më parë në Eastern Shore, e tani do të kthehet prapë në qytet, pa burrin që e shoqëronte, dhe gjithçka që e pret tani janë çapitjet në trotuare veshulllore vere bashkë me telefonatat e largëta në orën tre të mëngjezit që do t’ia prishin gjumin sikurse gjumin e trallisur në ato mëngjeze të avullta të atij gushti (të vitit 1960?1961?). Meqenëse do t’i duhet të shkoj menjëherë pas udhëtimit me tren për të drekuar në New York, ajo do të kish dashur të kish një mbërtheckë për kindin e lëshuar të fustanit të saj të mëndafshët, sikurse do kishte dashur ta harronte kindin dhe drekën e mëpasme dhe më mirë të rrinte në atë bar plot freski që mbante aromën e dizenfektantit dhe majasë së birrës dhe ta bënte shoqe gruan që mbante letrën e ambalazhit të një krepit të pisët kinez. Papandehur, atë e pushton njëfarë keqardhje për veten, gjë që e bën ta krahasoj gjendjen e saj me atë të Estelle. Kjo ishte e gjitha.

Pse e kam shkruar këtë shënim? Për ta kujtuar më vonë, pa dyshim, por çfarë ishte ajo që doja saktësisht të kujtoja? Sa nga ato që shkruajta ndodhi në realitet? Apo asgjë prej tyre s’ka ndodhur? Po pse në fund të fundit unë mbaj një bllok shënimesh? Është kaq e lehtë të përhumbesh në gjithë këto shënime. Shtysa për t’i shkruar gjërat, është posaçërisht e pashmangshme, gjë e pashpjegueshme për ata që nuk e ndiejnë këtë detyrim së brendshmi, i dobishëm nganjëherë, vetëm deri diku, përgjersa çdo lloj shtyse shtrënguese priret ta përlligj vetëveten. Ma merr mendja që kjo shtysë shfaqet ose jo qysh në djep. Megjithëse shtysën për të shkruar kam ndierë qëkur isha pesë vjeçe, nuk besoj që ime bijë do ta bëjë ndonjëherë këtë gjë, sepse ajo është e bekuar të fëmijë i vetëm dhe e pranor jetën ashtu siç vjen, pa pasur frikë kur shkon të flerë apo kur zgjohet.

Mbajtësit e blloqeve vetjake të shënimeve i përkasin një race krejtësisht të ndryshme, janë riformësues vetmitar të botës që nuk heqin dorë, fëmijë të pakënaqur qysh prej lindjes dhe të pushtuar prej njëfarë ndiesie të ankthshme dhe të kahershme humbjeje.

Shënimet e para i hodha në një bllok të madh shënimesh që ma dha ime më duke më këshilluar me

kujdes se në vend që të qahesha pa pushim të mësoja të argëtohesha duke shkruar mendimet e mia. Ma ktheu këtë bllok të hershëm para disa vitesh. Shënimet e para kanë të bëjnë me një grua që besonte se ishte duke ngrirë për vdekje gjatë një nate polare, natë pas së cilës ajo sheh se në fakt ishte degdisur në shkretëtirën e Saharasë, prej nxehtësisë së të cilës mund të vdiste para se të vinte dreka. S’kam asnjë lloj ideje se çfarë mund të ketë ngjallur në mendjen e një pesë vjeçareje një histori e tillë kaq “ironike” dhe ekzotike, por ajo shpërfaq deri diku një lloj prirje për të skajshmen, prirje e cila më ka karakterizuar e rritur, ndoshta nëse do të isha me natyrë më shumë analitike do të kisha shkruar një histori më të vërtetë si ajo e ditëlindjes së Donald Johnson-it apo se si ime kushërirë Brenda futi në akuarium të pëgërat e koteles sonë.

Pra, arsyeja e mbajtjes së një blloku shënimesh nuk ka qenë kurrë, sikurse nuk është as tani, të bëj regjistrim të saktë të fakteve ose të asaj që kam bërë apo menduar. Kjo do të kërkonte shtysë të tjetërllotë, instikt njohës të realitetit që megjithëse nganjëherë do të doja shumë ta kisha, nuk e zotëroj. Asnjëherë nuk kam qenë e zonja të mbaj në mënyrë të suksesshme ditar. Qasja ime e përditshme ndaj jetës ndryshon nga shpërfillja shumë e madhe deri tek mosprania e plotë, dhe gjatë këtyre pak rasteve kur jam përpjekur me përgjegjësi të plotë të kryej detyrën e marrë përsipër për të regjistruar ngjarjet e ditës, më ka kapur një mërzi aq e madhe sa përfundimi i një përpjekje të tillë ka qenë më së paku e papërfunduar. Çfarë kuptimi ka kjo puna e të shkruarit të shënimeve të tilla “Pazar, shtypja e disa letrave, Kush është E? Kjo “E” ishte person që vuante nga depresioni, apo mos vallë unë po përjetoja çaste depresioni? E kush e vret mendjen për këtë?

Ndryshe nga kjo mënyrë e pakuptim të shkruarit shënimesh të cilën e kam braktisur plotësisht unë zakonisht rrëfej ato të cilat çdokush do t’i quante gënjeshtër. “Kjo thjesht s’është fare e vërtetë,” më thonë anëtarët e tjerë të familjes time kur u rrëfej kujtimet e mia për një ngjarje pjesë e së cilës kemi qenë të gjithë. “Mbrëmja nuk ishte për ty, merimanga nuk ngjante si vejushë e zezë, nuk ka qenë aspak sikur e përshkruan ti.” Ka shumë gjasa që të kenë shumë të drejtë, se unë jo vetëm që e kam pasur gjithmonë të vështirë të bëj dallimin mes asaj që ka ndodhur dhe mund të ndodhë, por unë nuk jam e bindur, që ky dallim, ka ndonjë rëndësi duke pasur parasysh qëllimin përse janë hedhur këto shënime. Gaforrja tej mase e shijshme që më kujtohet të kem pasur për drekë ditën që im at erdhi në shtëpi nga Detroit-i në vitin 1945 duhet të ketë qenë sigurisht një zbulim, shkruar sipas modelit të atëherëshëm të dhënies së vërtetësisë. Dhjetë vjeçe isha e prej atëherë zor se do ta kujtoja gaforren tej mase të shijshme. Ngjarjet e asaj dite nuk i ngjanin një gaforreje tej mase të shijshme. Dhe sidoqoftë është saktësisht kjo gaforre tej mase e shijshme e trilluar që ma ndërmond gjithë atë pasdite, një film të parapëlqyer shtëpie që e shihnim shumë shpesh, dhuratat që mbante im at, një fëmijë që qante, depërtim në dashurinë dhe fajin familjar. Ose kështu më shpërfaqej mua të paktën. Po kështu, ndofta nuk ra borë kurrë atë gusht në Vermont. Ndoshta nuk pati shira ndërsa fryntë era natën, dhe ndoshta askush nuk pati ndiesinë se toka po ngurtësohej bashkë me verën që po jepte shpirt edhe pse të gjithë mëtonin që ishte

ngrohtë akoma, por ashtu ndieja unë, edhe mund të ketë rënë borë, mund të binte borë, ra borë.

Kësisoj e ndieva unë. Kjo është ajo çka të shpie më afër të vërtetës së një blloku shënimesh. Nganjëherë gënjej veten rreth faktit se pse mbaj bllok shënimesh, imagjinoni që një virtyt i përkorë formohet nga ruajtja e gjithçkaje që njeriu vëzhgon. Shih sa duhet dhe shkruaj për çfarë sheh, i them vetes, dhe pastaj në një mëngjez të zakonshëm kur bota nuk të duket e magjishme, një ditë kur e gjej veten të bëj vetvetiu gjërat që bëj çdo ditë, çfarë nënkupton të shkruarit - në atë mëngjez të dalë boje unë thjesht hap bllokun e shënimeve dhe ja ku janë përpara meje, një rrrëfim i harruar me interes që është shtuar me kalimin e kohës, copë kohe që ka ekzistuar në botën jashtë nesh: dialogë të dëgjuar në hotele dhe ashensorë apo tek kremastari i Pavillon-it (një mesoburrë dëftën me gisht kremastarin dhe thotë, “Në kapele kam numrin tim të hershëm që mbaja kur luaja futboll”); përshtypje të Bettina Aptheke-rit dhe Benjamin Sonnenberg-ut si dhe Teddy-t (Zoti Acapulco) Stauffer-it; më the të thashë të kujdeshme për të kolmet e tenisteve dhe modelet e dështuara apo trashëgimtarët greke të firmave të transportit, njëra prej të cilave më dha një mësim domethënës (mësim që mund ta kisha mësuar nga F. Scott Fitzgerald-i, por ndoshta ne duhet të gjithë të takojmë një ditë një të pasur për të mirën tonë) kur unë mbërrita për ta intervistuar në dhomën e ndenjes të mbushur me orkide ditën e dytë të një stuhie paralizuese bore në New York, e cila më pyeti nëse po binte borë jashtë.

Në përfytyrimin tim, me pak fjalë, në një bllok shënimesh shkruhet për të tjerët. Por sigurisht jo gjithmonë është domosdo kështu. Nuk është se më lidh ndonjë gjë me fjalët që një i panjohur i tha një tjetri në hollin ku është kremastari në Pavillon; në fakt dyshoj që fjalia “Numri në kapelen time është numri që mbaja kur luaja futboll” nuk e ka ngacmuar imagjinatën time, e të mos jetë kujtim i diçkaje që kam lexuar dikur. Prapë nuk është shqetësimi im gruaja që mban një letër ambalazhi krepit të pisët kinez në barin Wilmington. Vëmendja ime ishte gjithmonë, pa dyshim, tek vajza që nuk bie në sy me fustan të mëndafshët. Kini parasysh, gjithçka ishte ashtu si e ndieja unë: ky ishte qëllimi im, gjithmonë.

Është diçka e vështirë për ta pranuar. Rritemi me bindjen se të tjerët, kushdoqofshin ata, të gjithë të tjerët janë më interesant se ne vetë; na kanë mësuar të jemi modest, të mos nxjerrim në pah unin tonë. (“Ti je personi më pak i rëndësishëm në dhomë, këtë s’duhet ta harrosh,” guvernantja e Jessica Mitford-it do të gumëzhinte në veshët e tij në çdo ngjarje sociale; e hodha këtë në bllokun tim të shënimeve sepse vetëm tash së voni kam mundur të jem në një dhomë pa më kapur veshi një frazë të tillë.) Vetëm të rinjtë apo shumë të moshuarit mund të ritregojnë ëndërrat e tyre gjatë një dreke, të zhyten në reflektime, të pushtohen nga kujtime të pikniqeve në plazh dhe fustaneve “Liberty” të parapëlqyera në rendjet nëpër livadhe dhe ylberin e troftave në gjirin afër Colorado Springs. Ne të tjerët pritët që, sikurse është e udhës, të jepemi pas fustaneve të parapëlqyera të të tjerëve, sikurse tek troftat që sodisin ata.

Në fakt kështu bëjmë të gjithë. Por blloqet tona të shënimeve na japin liri, sepse sado që përpiqemi të regjistrojmë me saktësi atë që shohim rreth nesh, emëruesi i përbashkët e gjithçkaje që shohim është gjithmonë, në mënyrë shumë të qartë, dhe pa ndonjë ndjenjë turpi, “Uni” i pazëvendësueshëm. Nuk e kemi fjalën këtu për atë lloj blloku shënimesh që shkruhet qëllimisht për konsumim publik, pohime mençurake të strukturuar në mënyrë të tillë që të nxjerrin në pah mendime të mëdha. E kemi fjalën për diçka personale, grimca të shpërthimit të beftë të mendjes, një grumbull i rastësishëm dhe i hallakatur mendimesh që kanë kuptim vetëm për krijuesin e tyre.

Dhe nganjëherë edhe vetë krijuesi ka vështirësi me kuptimin. Nuk duket për shembull të ketë ndofarë rëndësie për mua të di gjatë pjesës tjetër të jetës që, në vitin 1964, 720 tonë blozë u hodhën në çdo milje metër katror të qytetit të New York-ut, por sidoqoftë e kam në bllokun tim të shënimeve, i etiketuar si

“FAKT”. Ashtu siç nuk është edhe aq e nevojshme për mua të kujtoj që shkrimtarit Ambrose Bierce i pëlqente ta gërmëzonte emrin e Leland Stanford-it si “Leland Stanford” apo që “gra të zgjuara pothuajse gjithmonë vishen me të zeza në Kubë,” tregues i modës pa shumë gjasa për zbatim praktik. Dhe a nuk duket rëndësia e shënimeve të mëposhtme më së paku periferike?

Në katin e poshtëm të muzeut të gjykatës së kontesë Inyo për pavarësinë, California, është një shënim i varur në një pallto: “Kjo PALLTO E VERDHË është përdour shpesh nga zonja Minnie S. Brooks kur ajo jepte leksione mbi koleksionin e saj të çajnikëve të çajit.” Një kokëkuq që del nga makina përballë hotelit Beverly Wilshire, vodhi çanta të markës Vuitton me etiketa që lexonin: ZONJA LOU FOX/HOTEL SAHARA/VEGAS. Epo, ndoshta nuk janë shënime krejtësisht të rëndësishme periferike. Në fakt, zonja Minnie S. Brooks dhe ajo PALLTO E VERDHË më ktheu prapa në fëmijërinë time, sepse edhe pse nuk nuk e kisha njohur zonjën Brooks dhe nuk e pata vizituar muzeun derisa isha në të tridhjetat, ngaqë u rrita në një botë të tillë, mes shtëpish plot me relike indiane dhe suvenire që halla ime Mercy Farnsworth na sillte nga orienti. Është një rrugë e gjatë që të shpie nga ajo botë tek bota e zonjës Lou Fox-it, botë në të cilën jetojmë të gjithë ne, dhe a nuk është e drejtë ta kujtosh këtë? A nuk po më ndihmon zonja Minnie S. Brooks të kujtoj se çfarë jam? A nuk po më kujton zonja Lou Fox të kujtoj se çfarë unë nuk jam?

Por nganjëherë është më e vështirë të shquash arsyen që qëndron pas shënimeve. Çfarë kisha saktësisht në mendje kur shënova që babait të një njohuri i kushtoi 650\$ në muaj të siguronte ndriçimin e lagjes Hudson në të cilën jetonte para aksidentit? Pse mendoja se do të hynte në punë kjo fjalë e thënë nga Jimmy Hoffa “Mund të kem bërë fajet e mia, por të gabosh nuk është një nga ato” Dhe megjithëse është interesante të dish se vajzat që angazhohen në aktivitetet e një sindikate kujdesen për modelin e flokëve gjithmonë kur kalojnë në West Coast, a do të më hyj menjëmend në punë ky fakt? A nuk do të ishte ndoshta më mirë të shkruaja që këtë e tha John O’ Hara? Ç’punë ka një recetë për lakër turshie në bllokun tim të shënimeve? Cili është filli lidhës i këtij blloku shënimesh. “Ai kishte lindur natën që u fundos titaniku.” Kjo duket të jetë një fjalë tërheqëse, dhe mua madje më kujtohet se kush e ka thënë, por a është një fjalë më e mirë kur thuhet në jetën e përditshme sesa mund të jetë në letërsi?

Por pa dyshim kjo është e gjitha; nuk është e rëndësishme nëse do ta përdor këtë fjalë por fakti që kjo fjalë më kujton gruan që e ka thënë si dhe atë pasdite kur e kam dëgjuar. Po rrinin në tarracën prej ku mund të shihnim detin, dhe po mbaronin verën e mbetur nga dreka, duke u përpjekur të merrnin çka mundeshim nga ngrohtësia e atij dielli në dimrin kalifornian. Gruaja i shoqi i së cilës kishte lindur natën që Titaniku u fundos donte të jepte me qira shtëpinë e saj, sepse donte të bashkohej me fëmijët në Paris. Më kujtohet që uroja të kisha mundësi të merrja shtëpinë e saj me qira e cila kushtonte 1.000 \$ në muaj. “Do të vijë dita që do të mundesh,” më tha ajo përtueshëm. “Vjen një ditë kur gjithçka njeriu do thjesht ndodh.” Atje, nën rrezet e diellit që binin mbi ne në tarracë dukej kaq e thjeshtë të besoje tek kjo ditë që vjen në jetën tënde, por më pas më kapi një dhimbje koke nga të pirët pa karar ndërsa ecja drejt një supermarketi dhe hasa rrugës një gjarpër të zi dhe paskëta më kapi një frikë e pashpjegueshme kur dëgjova shitësen e supermarketit që i shpjegonte një burri mu para meje se pse ajo më në fund do të divorcohej nga i shoqi. “Nuk më la asnjë mundësi zgjedhjeje tjetër,” përsëriti shumë herë ndërsa përgatiste faturën. “Ajo ka një bebe shtatë muajshe pranë saj e thotë sërish se ai nuk i la kurrfarë zgjedhjeje tjetër.” Dua të besoj se ai tmerr që ndieja në këtë kohë ishte për gjendjen njerëzore të saj, por në fakt kishte të bënte më mua vetë, sepse unë doja të kisha një bebe dhe nuk kisha pasur një të tillë deri atëherë dhe meqenëse doja të blija shtëpinë që kushtonte 1.000 \$ në muaj dhe gjithashtu sepse isha në fazën kur po më dilte pija.

Gjithçka të kujtohet sërish. Ndoshta është pak



e vështirë të dallosh vlerën e ndërmendjes së kësaj gjendjeje shpirtërore, por për mua është shumë e qartë; mendoj se është këshillë e mirë të kujtosh njerëzit që ke takuar rastësisht, pavarësisht nëse shoqëria e tyre ishte e këndshme apo jo. Përndryshe ata shfaqen sërish duke na befasuara, vijnë për të trokitur në derën e mendjes në orën 4 paradite gjatë një gjumi në shtrat dhe kërkojnë të dijnë se kush i ka braktisur ata, kush i ka tradhëtuar, dhe kush do ta bëjë këtë në të ardhmen. Ne po kështu harrojmë shumë shpejt gjëra që mendonim që nuk do të mund t’i harronim kurrë. Ne harrojmë njësoj si dashuritë dhe tradhëtitë, harrojmë çka pëshpëritëm dhe për çfarë vumë kujën, harrojmë se kush ishim më parë. Unë tashmë i kam shkëputur lidhjet me shumë njerëz që kam njohur. Jo se është ndonjë humbje e madhe, por do të ishte shumë interesante për mua të provoja edhe një herë ndiesinë që të ngjallet kur ulesh ndanë një lumi duke pirë vodka dhe lëng portokalli ndërsa dëgjon Les Paul-in dhe Mary Ford-in si dhe jehonën këngës së tyre që thotë “hëna na vështron nga lart” në radion e makinës. (E shihni, skenat më janë ngulitur në mendje, por e kam të vështirë të përfytyroj veten tek to, dhe nuk mund të improvizoj dialogje.) Njeriu tjetër është një njëzetë e tre vjeçare, kujtimi i së cilës nuk më shqetëson më.

Ajo gjithmonë hapte jo pak telashe, dhe nuk besoj që do ta takoj ndonjëherë vetëm nëse unë do të dua ta shoh sërish, mbante fustane të gjatë, e drojtur deri në acarim, gjithmonë në rolin e viktimës kur organizoheshin mbrëmjen dëfrimi, plot me akuza dhe ndjenja të lënduara dhe histori që nuk ma ka ënda t’i dëgjoj përsëri, që jo rrallë më trishtonin dhe më acaronin me dobësinë dhe paditurinë që shfaqnin, në fakt qëndrim këmbëngulës për të tërhequr vëmendjen si kompensim ndaj ndjesisë së të qenit gjithmonë e shpërfillur.

Është një ide e mirë atëherë, të ruash lidhjet, dhe mendoj që ruajtja e lidhjeve është ajo për të cilën shërben një bllok shënimesh. Dhe ne jemi krejtësisht vetëm me veten tonë kur vjen puna që të jemi të hapur ndaj këtyre shënimeve. Blloku juaj i shënimeve nuk më ndihmon dot mua sikurse blloku im i shënimeve nuk

ju hyn në punë juve. “Atëherë ç’të reja kemi nga tregtia e uiskit? Çfarë kuptimi ka kjo fjalë për ju? Për mua ka kuptimin e një gruaje bjonde që është ulur e veshur me një kostum banjoje Pucci me një dyshe burrash të shëndoshë në pishinën e hotelit të Beverly Hills. Një tjetër burrë afrohet dhe ata të gjithë shohin njëri tjetrin një grimëherë pa folur. - Atëherë ç’të reja kemi nga tregtia e uiskit? - pyet një nga burrat e shëndoshë si mënyrë për të nisur bisedën me ta, ndërsa bjondja ngrihet, ecën në majë të gishtave, dhe hidhet në pishinë ndërsa sheh gjatë gjithë kësaj kohe nga shezlongu ku Baby Pignatari fliste në telefon. Kaq ishte gjithçka që lidhet me këtë episod por, pas disa vitesh pash bjonden të shëtiste rrugës Saks Fifth Avenue në New York me çehren e saj kaliforniane dhe një pallto të vëllimshme gëzofi. Ndërsa frynte një erë e acartë ajo mu duk e moshuar dhe shumë e lodhur. Dhe madje edhe paltpja nuk ishte sipas modelit që ishte popullor atë vit, as ashtu sikur do ta donte ajo, dhe kjo përbënte thelbin e rrëfimit tim. Pak kohë pas kësaj kisha një lloj frike të shihja veten në pasqyrë dhe u hidhja një sy nxitimthi gazetave duke parë vetëm lajmërimet për vdekjet, për viktimat e kancerit, sëmundjet e parakohshme arteriale, vetvrasjet, dhe hoqa dorë nga kalimi përgjatë Lexington Avenue sepse për herë të parë vura re që të panjohur që kishte vite pa vënc re – njeriu që mbante lentë të zezë, lënësja që lexonte përditë rubrikat e gazetave, vajza e shëndoshë që zbriste gjithmonë në të njëjtën kohë me mua në Grand Central –ngjanin shumë më të moshuar se më parë.

Gjithçka të kujtohet sërish. Madje edhe ajo recetë për turshinë e lakrës: thjesht vetëm ky detaj të rikujton gjithçka. Unë isha në Fire Island kur përgatita për herë të parë turshinë e lakrës, po binte shi, dhe pimë shumë uiski, hëngrëm turshi lakre për të rënë gjumë aty rreth orës dhjetë, dhe më kujtohet se si dëgjova zhurmën e shiut atë natë në Atlantik ndërsa të gjitha këto më bënë të ndiehem e sigurtë. E përgatita turshinë e lakrës përsëri një natë më parë por nuk pata atë ndjenjë të dikurshme sigurie, por kjo është siç thuhet në raste të tilla, një tjetër histori.

Përktheu: Granit Zela

A close-up photograph of a woman's face and hand, both covered in numerous water droplets. She is looking through a glass pane, and her hand is pressed against it. The background is blurred, showing what appears to be a window with a view of trees. The overall mood is contemplative and emotional.

Samanta Schweblin

shtatë shtëpi të zbrazëta

Onufri Tregime